

**LIGJI Nr. 06/L -079**

**PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË**

**KREU I**

**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi**

1. Ky ligj përcakton kornizën ligjore të domosdoshme për promovimin dhe përmirësimin e efiçencës së energjisë në Republikën e Kosovës, me qëllim të përcaktimit të caqeve të efiçencës së energjisë dhe arritjen e këtyre caqeve në zbatim të planeve të veprimit për efiçencë të energjisë, zhvillimin e tregut të shërbimeve energjetike dhe masat tjera të efiçencës së energjisë.

2. Ky ligj rregullon aktivitetet që kanë për qëllim zvogëlimin e intensitetit energjetik në ekonominë shtetërore dhe që i kontribuojnë zvogëlimin të ndikimit negativ në mjedis të aktiviteteve që ndërlidhen me sektorin e energjisë.

3. Ky ligj transponon Direktivën 2012/27/BE të datës 25 tetor 2012 për efiçencën e energjisë, duke ndryshuar Direktivat 2009/125/KE dhe 2010/30/ BE dhe duke shfuqizuar Direktivat 2004/8/ EC dhe 2006/32 /BE.

4. Ky ligj siguron gjithashtu bazën ligjore për transpozimin e legjisllacionit që ndërlidhet me kornizën e etiketimit të performancës energjetike për produktet e ndërlidhura me energjinë.

**Neni 2**

**Fushëveprimi**

Ky ligj zbatohet nga të gjitha autoritetet publike dhe sektori privat, përfshirë ofruesit e shërbimeve të energjisë dhe mbulon tërë zinxhirin e energjisë, përfshirë burimet primare, prodhimin, depozitimin, transportimin, shpërndarjen, furnizimin dhe konsumin final të energjisë.

**Neni 3**

**Përkufizimet**

1. Termat e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **Agregator** - do të thotë një ofrues i shërbimit të kërkesës që kombinon ngarkesa të shumta të konsumit afatshkurtër për shitjen ose ofertën në tregjet e organizuara të energjisë.

1.2. **Institucionet qeveritare të nivelit qendror**-nënkupton të gjitha institucionet shtetërore që ushtrojnë kompetenca qeveritare dhe administrative, sipas Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës. Presidenca, Kuvendi, institucionet që raportojnë në Kuvend, kompanitë shtetërore që kryejnë veprimtari ekonomike ose të cilat operojnë në mënyrë të pavarur, nuk konsiderohen si institucione qeveritare të nivelit qendror për qëllime të këtij ligji.

1.3. **Bashkëprodhimi**- nënkupton procesin e prodhimit të njëkohshëm të energjisë elektrike dhe termike nga një burim energjetik gjatë të njëjtit proces teknologjik.

1.4. **Bashkëprodhimi me efikasitet të lartë**- është bashkëprodhim që plotëson kriteret e definuara në aktin nënligjor sipas paragrafit 1.2 të nenit 42 të këtij ligji.

1.5. **Energjia** – nënkupton çdo formë të prodhuar të energjisë (energji elektrike, energji termike ose gaz natyror, apo çfarëdo forme tjetër të energjisë) me qëllim të furnizimit ose të shitjes.

1.6. **Auditimi i energjisë** – është procedurë sistemike e realizuar nga një auditor i energjisë, qëllimi i së cilës është sigurimi i informatave të domosdoshme lidhur me profilin e konsumit të energjisë nga një ndërtesë apo grup ndërtesash, një veprimtari, instalim industrial apo komercial, apo një shërbim privat apo publik, me të cilin identifikohen dhe kuantifikohen mundësitë e kursimit kosto-efektiv të energjisë dhe raportohen rezultatet.

1.7. **Auditor i energjisë** – është personi fizik apo juridik i licencuar për kryerjen e auditimeve të energjisë në pajtim me nenin 12 të këtij ligji.

1.8. **Shpërndarësi i energjisë** – është personi fizik apo juridik, përfshirë operatorët e sistemit të shpërndarjes, përgjegjës për transportimin e energjisë me qëllim të dërgimit të saj të konsumatorët fundorë apo stacionet e shpërndarjes të cilat i shesin energji konsumatorëve fundorë;

1.9. **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes** - person fizik ose juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe sipas nevojës zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar, si dhe ku është e mundur interkonektorët e tij me sistemet tjera, si dhe për sigurimin e aftësisë afatgjatë të sistemit për të mbuluar kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë;

1.10. **Efikasiteti i energjisë** - raport mes performansës, shërbimit, produktit, apo energjisë së fituar dhe energjisë së shpenzuar për këtë qëllim;

1.11. **Përmirësimi i efikasitetit të energjisë** – do të thotë shtimi i efikasitetit të energjisë si rezultat i ndryshimeve teknologjike, ekonomike dhe/ose në mënyrën e sjelljes.

1.12. **Sistemi i menaxhimit të energjisë** – do të thotë një grup elementesh të ndërlidhura apo ndërvepruese që përcakton cakun e efikasitetit të energjisë dhe strategjinë për arritjen e caktit të tillë.

1.13. **Kontrata e performancës së energjisë**- është kontratë mes një përfituesi dhe një ofruesi të shërbimeve energjetike, me të cilën propozohen një apo më shumë masa për ngritjen e efiçencës së energjisë, e monitoruar dhe kontrolluar përgjatë tërë kohëzgjatjes së kontratës, me ç'rast investimet (aktivitetet, furnizimet apo shërbimet) për masat e tilla paguhen në proporcion me nivelin e ngritjes së efiçencës së energjisë, për të cilën është arritur marrëveshja në kontratë apo me kriteret tjera të realizimit të kontratës, siç mund të jenë kursimet financiare.

1.14. **Kursimi i energjisë** – sasia e energjisë së kursyer, e përcaktuar duke matur dhe ose parashikuar konsumin para dhe pas realizimit të një apo më shumë masave për ngritje të efiçencës së energjisë, në kontekst të normalizimit të kushteve të jashtme që ndikojnë në konsumin e energjisë.

1.15. **Shërbim energjetik** - do të thotë përfitimi fizik, dobia apo malli i nxjerr nga një kombinim i energjisë me teknologji me efiçencë të energjisë apo me veprim, që mund të përfshijë operacione, mirëmbajtje dhe kontroll të domosdoshëm për realizimin e shërbimit, që ofrohet në bazë të kontratës dhe në rrethana normale është dëshmuar të rezultojë në përmirësime të verifikueshme dhe të matshme apo të vlerësueshme të efiçencës së energjisë apo kursime primare të energjisë.

1.16. **Kompania për shërbime energjetike (ESCO)** – është person fizik apo juridik që ofron shërbime energjetike apo masa tjera të përmirësimit të efiçencës së energjisë në stabilimentet apo objektet e konsumatorit fundor, me qëllim të përmirësimit të efiçencës së energjisë në stabilimentet e tilla, me çka merr përsipër një pjesë të rrezikut financiar për kryerjen e shërbimeve të ofruara.

1.17. **Ofrues i shërbimeve të energjisë** - do të thotë personi fizik apo juridik që realizon shërbime të energjisë apo masa të tjera për përmirësim të efiçencës së energjisë në objektin apo centralin përfundimtar të konsumatorit

1.18. **Kontratë për furnizim me energji** - do të thotë një kontratë ndërmjet një përfituesi dhe një ofruesi të shërbimit të energjisë që përshkruan një apo më shumë masa për përmirësimin e efiçencës së furnizimit me energji duke ofruar shërbime siç janë ngrohja, ftohja, ajri i kompresuar apo energjia elektrike, apo forma të tjera të energjisë, duke përfshirë financimin, dizajnimin, inxhinierinë, planifikimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të prodhimit të energjisë.

1.19. **Konsumator fundor** – nënkupton person fizik apo juridik që blen energji për përdorim vetanak.

1.20. **Konsumi fundor i energjisë** – do të thotë tërë energjia e furnizuar për industri, transport, amvisëri, shërbime dhe bujqësi. Kjo nuk përfshin energjinë e liferuar në sektorin e prodhimit të energjisë dhe te vetë industrinë energjetike.

1.21. **Matësit inteligjentë**-janë mjete elektronike për matje të konsumit të energjisë, duke ofruar më shumë informata se pajisjet konvencionale të matjes, dhe të cilat mund të transmetojnë apo pranojnë informata duke përdorur forma të komunikimit elektronik.

1.22. **Agjencia e Kosovës për Efiçencë të Energjisë** - organ qendror i administratës shtetërore (në tekstin e mëtejme AKEE), e cila vepron në kuadër të ministrisë përgjegjëse për sektorin e energjisë.

1.23. **Ndërmarrjet e mëdha** – janë ndërmarrje që punësojnë dyqind e pesëdhjetë (250) apo më shumë persona, siç përcaktohet në Ligjin për Investimet e Huaja.

1.24. **Njësia mikro e bashkëprodhimit** -nënkupton njësinë e bashkëprodhimit me një kapacitet maksimal më të ulët se 50 kw.

1.25. **Ministria** – është Ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë;

1.26. **Ministër** - do të thotë Ministri i ministrisë përgjegjëse për sektorin e energjisë.

1.27. **Kodi i Matjes** - një përmbledhje e rregullave teknike dhe procedurave që përcaktojnë mënyrën e leximit të matësve, llogaritjen e energjisë së përdorur dhe faturimin në sektorin e energjisë.

1.28. **Plani Kombëtar i Veprimit për Efiçencë të Energjisë/PKVEE**-siç përkufizohet në nenin 5 të këtij ligji.

1.29. **Palë e obliguar** – është shpërndarësi i energjisë apo kompania e shitjes së energjisë me pakicë, që obligohet të veprojë në pajtim me nenin 10 të këtij Ligji.

1.30. **Masë politike** – do të thotë instrumenti rregullativ, financiar, fiskal, vullnetar apo për ofrim të informatave, i krijuar dhe zbatuar në Kosovë me qëllim të krijimit të një kornize përkrahëse, kërkesë apo masë stimuluese për akterët e tregut, për të ofruar dhe blerë shërbime energjetike dhe për të kryer masa tjera për përmirësimin e efiçencës së energjisë;

1.31. **Konsumi primar i energjisë** – është konsumi bruto i energjisë, duke përjashtuar përdorimin për nevoja joenergjiqe;

1.32. **Furnizues i energjisë me pakicë** – është personi fizik apo juridik i regjistruar në Republikën e Kosovës si organizatë afariste e cila u shet energji konsumatorëve fundorë;

1.33. **Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (në tekstin e mëtejme NVM)** – janë ndërmarrje që punësojnë përkatësisht deri dyzet e nëntë (49) dhe dyqind e dyzet e nëntë (249) persona, sipas Ligjit për Investimet e Huaja.

1.34. **Zona e gjithmbarshme e shfrytëzueshme** -do të thotë sipërfaqja e ndërtesës apo një pjese të ndërtesës për klimatizimin, ngrohjen dhe ftohjen e së cilës shfrytëzohet energjia.

1.35. **Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë (FKEE në tekstin e mëtejme Fondi)** – është entitet i pavarur, dhe i qëndrueshëm i përkufizuar si në nenin 24 dhe 25 të këtij ligji;

1.36. **Bordi i Drejtorëve** – është organ kryesor qeverisës i FKEE, përgjegjës për mbikëqyrjen e përgjithshme të FKEE në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

1.37. **Fondet** – janë të gjitha burimet financiare që i ndahen FKEE nga Qeveria e Kosovës, Institucionet Financiare Ndërkombëtare apo donatorët tjerë, me qëllim

të përkrahjes së investimeve në efikasitet të energjisë, duke siguruar njëkohësisht qëndrueshmërinë afatgjatë të tij, në bazë të këtij ligji.

1.38. **Kapitali** – janë burimet financiare të FKEE, përfshirë të gjitha shumat në dispozicion të depozitave të FKEE për të përkrahur investimet në EE, si dhe shumat e burimeve financiare të investuara të cilat duhet t'i kthehen Fondit nga përfituesit.

1.39. **Qarkullues** – është investimi i sërishëm i kapitalit të kthyer në Fond nga përfituesit që kanë realizuar investimet në efikasitet të energjisë në bazë të financimit nga Fondi.

1.40. **Investimet e pranueshme** – janë investimet të cilat i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë dhe politikave investuese, siç specifikohen në këtë ligj dhe në rregulloret e brendshme të Fondit.

1.41. **Marrëveshje Ndërkombëtare e Financimit** – janë marrëveshje, pa marrë parasysh formën ligjore të tyre, të nënshkuara mes një donatori apo Institucioni Financiar Ndërkombëtar dhe Republikës së Kosovës, që specifikojnë përdorimin e fondeve të ofruara nga donatori, llojet e investimeve të pranueshme dhe kushtet dhe konditat tjera që asocohen me fondet e donatorëve.

1.42. **Marrëveshje për Shërbime Energjetike** – janë marrëveshje ligjore e nënshkuara mes FKEE dhe një subjekti publik që i mundësojnë FKEE të ofrojë shërbime të plota përfshirë financimin për zbatimin e projekteve të efikasitetit të energjisë dhe t'i rikthejë investimet nga subjekti publik, bazuar në kursimet e parashikuara të kostos së energjisë kundrejt energjisë bazë, para investimit.

1.43. **Entitete publike** – janë institucionet e qeveritare të nivelit qendror dhe autoritetet lokale që mund të pranojnë përkrahje për investime nga FKEE, në bazë të Marrëveshjeve për Shërbime Energjetike apo të përfitojnë nga instrumentet tjera financiare relevante të themeluara nga FKEE.

1.44. **Konsumatori familjar** – është çdo person apo grup personash që ka në pronësi dhe ose posedim prona të destinuar për banim, apo që kanë të drejtë të pranojnë përkrahje nga FKEE për investime në efikasitet të energjisë.

1.45. **Energjia bazë** – është konsumi mesatar i energjisë dhe kostot e energjisë për një periudhë adekuate prej së paku dy (2) viteve para zbatimit të investimit, siç llogaritet përmes Auditimit të Energjisë. Energjia bazë normalizohet duke përdorur variabla që ndikojnë në konsumin e energjisë, siç janë niveli i komfortit termal, ndriçimi, ventilimi dhe nivelet e tjera të komfortit siç përcaktohet me rregullat dhe rregulloret në fuqi, kushtet mesatare klimatike në lokacion dhe variabla të tjerë relevantë. Normalizimi i energjisë bazë do të bëhet sipas praktikave të mira inxhinierike dhe në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare për menaxhimin e energjisë dhe auditimin e energjisë.

1.46. **Kursimet e parapara të kostos së energjisë** – kursimi i energjisë dhe kostove që pritet të realizohet nga investimi në efikasitet të energjisë, i kalkuluar nën të njëjtat kushte që janë shfrytëzuar për të përcaktuar energjinë bazë.

1.47. **Financimi/grant/llojtjetër/marrëveshja** - çdo lloj tjetër i marrëveshjes ligjore mes FKEE dhe përfituesve që i mundëson FKEE t'i ofrojë përkrahje financiare të kombinuara apo jo me grante dhe ose asistencë teknike për implementimin e investimeve në fushën e efikasitetit të energjisë.

1.48. **Skema obliguese për eficiency të energjisë** – është skema për eficiency të energjisë siç përcaktohet në nenin 10 të këtij ligji.

1.49. **Energji termike** – energjia për ngrohjen/ftohjen e hapësirave, ngrohjen e ujit sanitar dhe ujit industrial, që transmetohet dhe shpërndahet përmes ujit, avullit, ose gazrave, e përfituar nga stabilimentet e energjisë termike, duke përdorur lëndët djegëse, burimet gjeotermale, energjinë solare, energjinë termike të pashfrytëzuar, me të cilën furnizohen konsumatorët përmes sistemeve qendrore të energjisë termike.

1.50. **Produkt i lidhur me energjinë ose produkt** - do të thotë një mall ose sistem me ndikim në konsumin e energjisë gjatë përdorimit, që vendoset në treg ose futet në shërbim, duke përfshirë pjesët me ndikim në konsumin e energjisë gjatë përdorimit të cilat vendosen në treg ose futen në shërbim për konsumatorë dhe që janë të destinuara që të inkorporohen në produkte.

1.51. **Fletëinformacioni i produktit (ose fisha e produktit)** - do të thotë një dokument standard që përmban informacion lidhur me një produkt, në formë të shtypur ose elektronike.

1.52. **Burime të tjera thelbësore** - do të thotë ujë, kimikate ose substanca të tjera të konsumuara nga një produkt gjatë përdorimit normal.

1.53. **Tregtar** - do të thotë një shitës me pakicë ose një person tjetër fizik ose juridik që ofron për shitje, angazhon, ose angazhon blerjen, ose që ekspozon produkte për konsumatorë ose instalues në kuadër të një veprimtarie tregtare, qoftë me pagesë ose pa pagesë.

1.54. **Furnizues (i produktit të lidhur me energji)** - do të thotë prodhues, përfaqësues i autorizuar i një prodhuesi, ose importues, që vendosë një produkt në tregun e Republikës së Kosovës.

1.55. **Vendosja në treg** - do të thotë vënia në dispozicion për herë të parë e një produkti në tregun e Republikës së Kosovës.

1.56. **Futja në shërbim** - do të thotë përdorimi i parë i një produkti sipas qëllimit të tij të synuar në tregun e Republikën e Kosovës.

1.57. **Grup i produkteve** - do të thotë një grup i produkteve të cilat e kanë funksionalitetin kryesorë të njëjtë.

1.58. **Etiketë** - do të thotë një diagram grafik, qoftë në formë të shtypur apo elektronike, duke përfshirë një shkallëzim të mbyllur që përdorë vetëm shkronja, ku çdo shkronjë paraqet një klasë dhe secila klasë korrespondon me kursimin e energjisë, me ngjyra të ndryshme, me qëllim që t'i informojë konsumatorët për eficiency e energjisë dhe konsumin e energjisë.

1.59. **Dokumentacion teknik** - do të thotë dokumentacion i mjaftueshëm për t'iu mundësuar autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut të vlerësojnë saktësinë e etiketës dhe të fletëinformacionit të një produkti, duke përfshirë raportet e testeve ose dëshmitë e ngjashme teknike.

1.60. **Vënia në dispozicion në treg** - do të thotë furnizimi i një produkti për shpërndarje apo përdorim në tregun e Republikës së Kosovës në kuadër të një veprimtarie tregtare, qoftë me pagesë apo pa pagesë.

## **KREU II**

### **POLITIKAT E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË**

#### **Neni 4**

#### **Objektivat nacionale caqet dhe masat politike në fushën e efiçencës së energjisë**

1. Ministria përcakton cakun kombëtar të efiçencës së energjisë për konsumin final të energjisë që nuk kalon 1556 Ktoe në vitin 2020.

2. Objektivat në fushën e efiçencës së energjisë janë si në vijim:

2.1. largimi i barrierave për promovimin e efiçencës së energjisë;

2.2. vënia në funksion e teknologjive me efiçencë të lartë të energjisë, e sistemeve moderne të matjes dhe kontrollit, dhe sistemeve për menaxhimin e energjisë;

2.3. aplikimi i metodave moderne të menaxhimit të energjisë;

2.4. promovimi i përdorimit të pajisjeve dhe makinerisë efiçente, si dhe burimeve të ripërtërishme të energjisë.

2.5. promovimi i mekanizmave dhe instrumenteve financiare dhe ofrimi i masave stimuluese financiare dhe fiskale në përputhje me këtë ligj

2.6. mobilizimi i investimeve në renovim të ndërtesave.

2.7. bashkëpunimi mes konsumatorëve fundorë të energjisë, prodhuesve, furnizuesve të energjisë me pakicë, shpërndarësve të energjisë dhe institucioneve e autoriteteve publike, me qëllim të arritjes së objektivave kombëtare të politikave për efiçencën e energjisë.

2.8. sigurimi i auditimeve energjetike të cilësisë së lartë, sistemeve të menaxhimit të energjisë dhe shërbimeve energjetike në treg.

2.9. edukimi dhe ngritja e vetëdijes së konsumatorëve të energjisë mbi rëndësinë dhe përfitimet nga zbatimi i masave për ngritje të efiçencës së energjisë;

2.10. promovimi i hulumtimeve themelore dhe aplikative në fushën e efiçencës së energjisë.

## Neni 5

### Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencë të Energjisë dhe Raporti Vjetor i Progresit

1. Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) përcakton dhe përshkruan veprimet për arritjen e objektivave të politikës shtetërore në fushën e eficiencës së energjisë, duke përfshirë skemën e detyrimeve të eficiencës së energjisë, masat e politikave të eficiencës së energjisë, kursimet e energjisë të arritura ose të parashikuara për t'u arritur në nivel të furnizimit, transmetimit, shpërndarjes dhe konsumit final të energjisë, me qëllim që të përmbushen caqet kombëtare të eficiencës së energjisë.
2. Duke filluar nga data 30 prill 2019 për çdo tri (3) vite në vijim, AKEE në bashkëpunim me palët e tjera përgjegjëse, rishikon PKVEE të cilin ia dërgon Ministrisë për shqyrtim dhe procedim të mëtejshëm te Qeveria e Kosovës për miratim. Plani përfshin caqet tre (3) vjeçare të EE.
3. Pas miratimit nga Qeveria, PKVEE publikohet në web-faqen zyrtare të Ministrisë dhe i dërgohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë jo më vonë se deri më 30 prill të vitit përkatës.
4. PKVEE i rishikuar përfshin edhe raportin e progresit për planin paraparak tre (3) vjeçar të EE, duke përfshirë plotësimin e caqeve të këtij plani.
5. PKVEE përfshin një vlerësim dhe, sipas nevojës, barrierat rregullative dhe jorregullative për eficiencë të energjisë, si dhe të parasheh masat për largimin e tyre, përfshirë masat që ofrojnë stimulim, shfuqizojnë apo ndryshojnë dispozita ligjore apo rregullative, miratojnë udhëzime dhe ose thjeshtësojnë procedura administrative.
6. Ministria nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e kornizës së përgjithshme për PKVEE duke përfshirë edhe kërkesat e raportimit.
7. Në baza vjetore, deri më 30 qershor të çdo viti, AKEE përgatit raportin e progresit mbi përparimin në raportimin e caqeve vjetore të eficiencës së energjisë, në pajtim me aktin nënligjor të përcaktuar në paragrafi 1.13 të nenit 42 të këtij ligji. Platforma e monitorimit dhe verifikimit (PMV) do të përdoret, kur është e mundur, në llogaritjen e kursimeve të energjisë dhe raportimit mbi masat e PKVEE. Raporti i dorëzohet Qeverisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
8. Në mënyrë që të krahasohen kursimet e energjisë dhe të kryhet konvertimi në një njësi krahasuese, faktorët e konvertimit do të definohen në aktin nënligjor siç përcaktohet në paragrafi 1.5 të nenit 42 të këtij ligji.
9. Çdo vit, deri më 30 Prill, të gjitha palët përgjegjëse sipas PKVEE janë të obliguara të raportojnë te AKEE për zbatimin e aktiviteteve të tyre të parapara në PKVEE.

## Neni 6

### Planet Komunale të Veprimit për Eficiencë të Energjisë, zbatimi dhe raportimi

1. Duke filluar nga 28 shkurt i vitit 2019, për çdo tri (3) vite, komunat përgatisin dhe dorëzojnë në AKEE draft-planet komunale të veprimit për eficiencë të energjisë, të cilat do të përfshijnë politikat e propozuara të eficiencës së energjisë dhe masat për përmirësimin e eficiencës së energjisë, të cilat mbulojnë të gjithë sektorët që funksionojnë në nivel komunal.
2. Para miratimit të Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë nga Kuvendi Komunal,



AKEE do të vlerësojë përputhshmërinë e tij me politikat kombëtare të efijencës së energjisë, caqet dhe planet përkatëse dhe ta japë opinionin me rekomandime, brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e parashtrimit të draft-planit sipas paragrafit 1 të këtij neni. Miratimi i Planeve Komunale të Veprimit për Efijencë të Energjisë nga Kuvendi Komunal duhet të bëhet para datës 31 mars të vitit përkatës dhe i njëjti duhet të mbulojë tri (3) vitet në vijim.

3. Plani, veç tjerash, parashikon krijimin dhe funksionimin e sistemeve komunale të menaxhimit të energjisë dhe monitorimit, sipas rastit, sistemeve individuale të menaxhimit të energjisë, duke përfshirë auditimin e energjisë për ndërtesat që konsumojnë energji të mëdha dhe ose kompanitë komunale, si dhe për renovimin e ndërtesave publike për të përmbushur standardet minimale të performancës së energjisë të përcaktuara me Ligjin për Performancën e Energjisë në Ndërtesa, dhe masat e tjera të efijencës së energjisë të ndërmarra në objektet nën kontrollin e komunave.

4. Me qëllim të zbatimit të sistemit komunal të menaxhimit të energjisë, komunat funksionalizojnë zyrat komunale të energjisë me personel të kualifikuar për menaxhimin e energjisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Çdo vit dhe jo më vonë se data 30 prill, Kuvendi Komunal miraton dhe ia dorëzon AKEE raportin e progresit për zbatimin e Planit Komunal të Veprimit për Efijencën e Energjisë për vitin paraprak. Komunat duhet të përdorin platformën e veçantë të softuerit dhe ose faqen e të dhënave për raportim. Platforma e Monitorimit dhe Verifikimit sigurohet nga AKEE.

6. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga pranimi i raportit, sipas paragrafit 5 të këtij neni, AKEE vlerëson progresin e arritur, vlerëson nevojat dhe propozon masat përmirësuese apo të tjera për zbatimin e PKVEE në nivel lokal. Në bazë të vërejtjeve të AKEE, Komunat ndryshojnë, nëse kërkohet, Planin Komunal të Veprimit për periudhën e mbetur për zbatim, jo më vonë se deri më 30 Nëntor të vitit përkatës.

7. Ministria nxjerr një model për përcaktimin e formës dhe përmbajtjes së Planit Komunal të Veprimit për Efijencë të Energjisë dhe formën dhe përmbajtjen e Raportit të Progresit për Zbatimin e Planit Komunal të Veprimit për Efijencë të Energjisë, jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

8. Komunat monitorojnë rregullisht zbatimin e planit dhe arritjen e caqeve të kursimit të energjisë. Për këtë qëllim, komunat duhet të krijojnë dhe menaxhojnë një sistem informacioni për mbledhjen e të dhënave për konsumin e energjisë në ndërtesat komunale dhe monitorojnë kursimet e realizuara nga zbatimi i masave në ndërtesat publike, duke përdorur platformën e bazuar në faqen zyrtare elektronike për raportim, Platforma e Monitorimit dhe Verifikimit (MVP).

9. Komunat do të promovojnë në nivel lokal politikat kombëtare për efijencë të energjisë, dhe do t'i informojnë qytetarët mbi përfitimet nga masat për ngritje të efijencës së energjisë dhe mënyrën e realizimit të tyre.

10. Komunat, si dhe institucionet tjera publike në nivel lokal dhe qendror, shfrytëzojnë, kurdo që kjo është e mundshme, kompanitë e shërbimeve energjetike dhe kontraktimin e performancës energjetike për renovime dhe implementim të planeve për të përmirësuar efijencën e energjisë në aspektin afatgjatë.

### **KREU III**

## **EFIÇIENCA NË PËRDORIMIN E ENERGJISË**

### **Neni 7**

#### **Strategjia për rinovimin e ndërtesave**

1. Ministria, e mbështetur nga AKEE dhe në bashkëpunim me ministritë e linjës përgjegjëse për ndërtim dhe apo administrim të ndërtesave, zhvillon Strategjinë afatgjate për mobilizimin e investimeve për rinovime të ndërtesave të banimit dhe atyre komerciale, publike dhe private. Ministria dorëzon Draftin e Strategjisë në Qeveri për aprovim jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, si dokument të veçantë. Strategjia duhet të përfshijë si në vijim:

1.1. një pasqyrë të stokut të ndërtesave në nivel vendi bazuar në të dhënat statistikore dhe ose një mostër, sipas nevojës, të kategorive të ndërtesave;

1.2. identifikimi i qasjeve kost-efektive për rinovimet që lidhen me llojin e ndërtesave dhe zonën klimatike;

1.3. politikat dhe masat për stimulimin e rinovimeve të thella kost-efektive të ndërtesave duke përfshirë rinovimet e thella në faza;

1.4. një perspektivë të ardhshme që jep udhëzim të investimeve të individëve, industrisë së ndërtimit dhe institucioneve financiare;

1.5. një vlerësim të bazuar në dëshmi të kursimeve të pritshme të energjisë dhe përfitimeve më të gjera.

2. Strategjia do të marrë parasysh caqet e efijencës së energjisë sipas Planit Kombëtar të Veprimit për Efijencë të Energjisë, si dhe aspektet sociale që mund të kontribuojnë në zbutjen e varfërisë energjetike.

3. Pas miratimit nga Qeveria, Strategjia publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë. Strategjia do të përditësohet çdo tri (3) vite dhe do të dorëzohet në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë.

### **Neni 8**

#### **Renovimi i ndërtesave publike**

1. Për ta demonstruar rolin shembullor të organeve publike në performancën energjetike të ndërtesave, Qeveria e Republikës së Kosovës rinovon një përqind (1%) të sipërfaqes totale të kateve të ndërtesave me ngrohje dhe ose me ftohje në pronësi dhe shfrytëzim nga institucionet qeveritare të nivelit qendror, çdo vit, për të përmbushur së paku kërkesat minimale për performancën e energjisë në pajtim me Ligjin për Performancën e Energjisë në ndërtesa.

2. Shkalla e renovimit prej një përqind (1%) do të llogaritet nga data 1 dhjetor 2017 dhe llogaritet në sipërfaqen e përgjithshme të ndërtesave me sipërfaqe të përgjithshme të shfrytëzueshme mbi pesëqind metër katror (500 m<sup>2</sup>) që në 1 janar të çdo viti, nuk i përmbushin kërkesat kombëtare të performancës minimale të energjisë sipas Ligjit mbi Performancën e Energjisë në ndërtesa. Ky prag duhet të ulet në dyqind e pesëdhjetë (250 m<sup>2</sup>) nga 1 janari 2019 .

3. Gjatë zbatimit të masave për rinovimin gjithëpërfshirës të ndërtesave të qeverisë qendrore

në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, duhet të merret parasysh ndërtesa në tërësi, duke përfshirë mbulojën, pajisjet, funksionimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës.

4. Kërkesat e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për kategoritë vijuese të ndërtesave:

4.1. ndërtesat që janë pjesë e trashëgimisë kulturore kombëtare dhe nëse përmbushja e kërkesave minimale të performancës së energjisë do të ndryshonte karakterin ose paraqitjen e tyre në mënyrë të papranueshme;

4.2. ndërtesat në pronësi të forcave të armatosura ose qeverisë qendrore dhe që i shërbejnë qëllimeve të mbrojtjes kombëtare, përveç banesave individuale të banimit ose ndërtesave të zyrave për forcat e armatosura dhe stafin tjetër të punësuar nga autoritetet kombëtare të mbrojtjes;

4.3. ndërtesat që përdoren si objektet e kultit dhe ato për aktivitete fetare.

5. Nëse gjatë një viti ndërtesat e renovuara të sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni tejkalojnë shkallën prej një përqind (1%), kjo mund të llogaritet drejt normës vjetore të renovimit të cilësdo nga tri (3) vitet e mëparshme ose pasardhëse.

6. Ndërtesat e reja të shfrytëzuara dhe në pronësi si zëvendësime për objekte specifike të qeverisë qendrore të demoluara në cilindo nga dy (2) vitet e mëparshme, ose ndërtesat që janë shitur, demoluar ose larguar nga përdorimi në cilindo nga dy vitet e mëparshme si pasojë e përdorimit më intensiv të ndërtesave të tjera mund të llogariten drejt normës vjetore të renovimit.

7. Deri më 31 Korrik 2019, AKEE, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për menaxhimin e ndërtesave publike, përgatit dhe do të bëjë publik një inventar të ndërtesave të institucioneve qeveritare të nivelit qendror nga paragrafi 2 i këtij neni duke mos përfshirë ndërtesat nga paragrafi 4 i këtij neni. Ky inventar duhet të përmbajë së paku të dhënat si në vijim:

7.1. sipërfaqen e dyshemesë në m<sup>2</sup>; dhe

7.2. performancën e energjisë të çdo ndërtese ose të dhënat përkatëse të energjisë.

8. Ministria, e mbështetur nga AKEE dhe FKEE, përgatit dhe dorëzon për miratim në Qeveri, akte nënligjore për Planin tre (3) vjeçar të renovimit për ndërtesat e qeverisë qendrore që do të përcaktojnë së paku:

8.1. listën e ndërtesave në pronësi dhe të shfrytëzuara nga qeveria qendrore që do të renovohen çdo vit, masat kryesore të efiçencës së energjisë dhe kostot e parashikuara të investimeve.

8.2. aranzhimet e zbatimit për renovimin e ndërtesave duke përfshirë mundësinë për të transferuar këtë përgjegjësi tek FKEE.

8.3. burimet dhe metodat e financimit të investimeve përfshirë përgatitjen e projekteve, tenderimin, zbatimin e furnizimeve dhe punëve, si dhe verifikimin pas zbatimit.

8.4. mënyrën raportimit tek AKEE mbi progresin e zbatimit të planit të renovimit.

9. AKEE është përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e një skeme për arritjen e kërkesave minimale të performancës së energjisë në ndërtesat e renovuara.

10. Çdo vit, deri më 31 Maj, në bashkëpunim me FKEE, sipas nevojës, AKEE përgatit dhe dorëzon në Ministri raportin që përfshin informata mbi ndryshimet e nevojshme në planin tre (3) vjeçar të renovimit të ndërtesave të institucioneve të qeverisë qendrore, nëse kërkohet, numrin e kontratave të përfunduara gjatë vitit të kaluar, shkallën vjetore e renovimit të ndërtesave, masat e efijencës së energjisë dhe shpenzimet e përgjithshme të realizuara, rezultatet e verifikimit dhe kursimet e energjisë të arritura gjatë vitit të kaluar, si dhe informacione të tjera relevante. Raporti do të publikohet në faqet zyrtare të Ministrisë.

11. Qeveria e Kosovës do të inkurajojë organet e tjera publike që nuk i përkasin institucioneve qeveritare të nivelit qendror siç përcaktohet në paragrafi 1.2 të nenin 3 të këtij ligji, duke përfshirë organet rajonale dhe lokale, si dhe organet e tjera të qeverisura nga e drejta publike, që të zbatojnë planet e renovimit të ndërtesave në pronësi dhe shfrytëzim nga to, duke ndjekur rolin ekzemplar të ndërtesave të institucioneve qeveritare të nivelit qendror të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

## **Neni 9**

### **Blerja nga organet publike**

1. Autoritetet dhe organet e administratës qendrore dhe lokale, si dhe të gjitha autoritetet ose subjektet tjera publike që zbatojnë Ligjin për Prokurimin Publik dhe ose FKEE, do të blejnë vetëm produkte, shërbime dhe ndërtesa me performancë të lartë të efijencës së energjisë, në pajtim me Udhëzimin Administrativ sipas paragrafit 1.3 të nenit 42 të këtij ligji.

2. Paragrafi 1 i këtij neni aplikohet edhe për personat juridikë privatë në rast të kontraktimit të prokurimeve të punimeve, furnizimeve ose shërbimeve të financuara dhe ose të subvencionuara me së paku 50% nga fondet publike ose me mbështetje financiare të FKEE.

3. Detyrimi i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni zbatohet për kontratat e forcave të armatosura vetëm në atë masë që zbatimi i tij nuk shkakton konflikt me natyrën dhe qëllimin parësor të veprimtarisë së forcave të armatosura.

4. Gjatë tenderimit të kontratave të shërbimeve me përmbajtje të konsiderueshme të energjisë, autoritetet dhe organet e cekura në paragrafin 1 të këtij neni do të vlerësojnë mundësinë e lidhjes së kontratave afatgjata të performancës së energjisë që sigurojnë kursime afatgjata të energjisë.

5. Pa paragjykuar paragrafin 1 të këtij neni, gjatë blerjes së pakove të produkteve të mbuluara në tërësi nga një akt i deleguar i miratuar në kuadër të legjislacionit mbi etiketimin e energjisë të produkteve që lidhen me energjinë, efijencia e përgjithshme e energjisë duhet të ketë prioritet mbi efijencën e energjisë së produkteve individuale brenda asaj pakoje, duke blerë pakon e produktit që përputhet me kriterin që i përket klasës më të lartë të efijencës së energjisë.

## **Neni 10**

### **Skema obligative për efijencë të energjisë**

1. Ministria krijon Skemën Obligative për Efijencë të Energjisë që ka për qëllim arritjen e cakut kumulativ të kursimit të energjisë siç përcaktohet në paragrafët 3, 4 dhe 5 të këtij neni. Caku do të arrihet me kombinim të zbatimit të Masave Alternative siç përcaktohet në paragrafët 6, 7 dhe

8 të këtij neni dhe duke imponuar detyrime të kursimeve të energjisë ndaj palëve të detyruara.

2. Operatorët e Sistemit të Energjisë Elektrike dhe/apo energjisë termike ose kompanitë e shitjes me pakicë të energjisë dhe ose shpërndarësit e lëndës djegëse të lëngshme të energjisë për shitësit me pakicë dhe ose që furnizojnë drejtpërdrejt lëndë djegëse për konsumatorët fundorë që veprojnë në territorin e Republikës së Kosovës sipas legjislacionit përkatës, konsiderohen Palë të Detyruara të skemës së detyrimeve të efijencës së energjisë. Nga radhët e atyre Palëve të Detyruara, Qeveria do të përcaktojë ata që do të kontribuojnë në arritjen e objektivave të detyrimeve të efijencës së energjisë në përputhje me paragrafin 9 të këtij neni.

3. Kursimet kumulative të energjisë sipas skemës së detyrimit të energjisë do të jenë në nivel ekuivalent me arritjen e kursimeve të reja çdo vit që korrespondojnë me periudhën nga 1 janar 2017 deri më 31 dhjetor 2020 prej zero pikë shtatë përqind (0.7%) të shitjeve vjetore të energjisë për konsumatorët fundorë të të gjitha formave të energjisë në vëllim, mesatarisht për periudhën më të fundit tre (3) vjeçare para 1 janarit 2016. Shitja e energjisë, sipas vëllimit, që përdoret në transport përjashtohet nga kjo llogaritje.

4. AKEE, përcakton kursimet kumulative të energjisë që duhet të arrihen që korrespondojnë me periudhën kohore të cekur në paragrafin 3 të këtij neni. Gjatë llogaritjeve të kursimeve kumulative të energjisë të cekura në paragrafin 3 të këtij neni, AKEE do të:

4.1 përdor vlerat e përqindjes prej zero pikë pesë përqind (0,5%) për vitet 2017 dhe 2018 dhe zero pikë shtatë përqind (0.7%) për vitet 2019 dhe 2020;

4.2 lejon që kursimet e energjisë të arritura në sektorët e prodhimit, shpërndarjes dhe transmetimit të energjisë, përfshirë infrastrukturën efijente të sistemit të ngrohjes dhe ftohjes qendrore, si rezultat i zbatimit të kërkesave të përcaktuara në paragrafi 3 të nenit 19 dhe nenit 20 të këtij ligji të llogariten në masën e kursimeve të energjisë të kërkuara sipas paragrafit 3 të këtij neni ;

4.3 lejon që kursimet e energjisë që rezultojnë nga veprimet individuale të reja të zbatuara nga 31 dhjetori 2008 e që vazhdojnë të kenë ndikim në vitin 2020 dhe që mund të maten dhe verifikohen, të llogariten në masën e kursimeve të energjisë të kërkuara sipas paragrafit 3 të këtij neni.

5. Zbatimi i paragrafit 3 nuk rezulton me një zbritje prej më tepër se njëzet e pesë përqind (25%) të sasisë së kursimit të energjisë sipas paragrafit 3 të këtij neni Ministria njofton Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë lidhur me paragrafin 3, jo më vonë se 31 korrik 2018 përfshirë elementët e listuar në paragrafin 3 të këtij neni, që janë zbatuar dhe llogaritjen që tregon ndikimin e tyre në sasinë e kursimeve të energjisë të referuara në paragrafin 3 të këtij neni.

6. Si alternativë e imponimit të të skemave obligative për efijencë të energjisë ndaj palëve të obliguara, Ministria zgjedh të merr masa të tjera të politikave për përmbushjen e pjesëshme të kursimeve të energjisë te konsumatorët fundorë, me kusht që këto masa të politikave përmbushin kriteret sipas paragrafit 7 dhe 8 të këtij neni. Shuma vjetore e kursimeve të reja të energjisë të arritura nëpërmjet kësaj qasjeje do të jetë ekuivalente ose do të korrespondojë me përqindjen e sasisë së kursimeve të reja të energjisë sipas paragrafëve 3, 4 dhe 5 të këtij neni AKEE propozon masat e politikave sipas këtij neni, ndërsa Ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, dorëzon listën e masave të Qeveria për miratim. Masat e politikave mund të përfshijnë, mes tjerash, masat vijuese të politikave ose kombinime të tyre:

6.1. taksat e energjisë ose të CO2 që kanë efekt të reduktimit të konsumit të energjisë nga përdorimi final.

6.2 skemat dhe instrumentet e financimit ose stimulimet fiskale që çojnë në aplikimin e teknologjisë ose teknikave efikente të energjisë dhe kanë efekt të zvogëlimit të konsumit të energjisë në përdorimin fundor.

6.3 rregulloret ose marrëveshjet vullnetare që çojnë në aplikimin e teknologjisë ose teknikave efikente të energjisë dhe kanë efekt të zvogëlimit të konsumit të energjisë në përdorimin fundor.

6.4 standardet dhe normat që kanë për qëllim përmirësimin e efikencës së energjisë të produkteve dhe shërbimeve, duke përfshirë ndërtesat dhe automjetet, përveç në rastet kur ato janë të detyrueshme dhe të zbatueshme në Kosovë.

6.5 skemat e etikimit të energjisë, me përjashtim të atyre që janë të detyrueshme dhe të zbatueshme në Kosovë.

6.6. trajnim dhe edukim, duke përfshirë programuesit këshillues për energji, që çojnë në aplikimin e teknologjisë ose teknikave efikente të energjisë dhe kanë efekt të zvogëlimit të konsumit të energjisë në përdorimin fundor.

6.7. masat e tjera të politikave.

7. Ministria do të njoftojë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë mbi masat e politikave që do t'i miratojë, sipas kornizës së parashikuar në paragrafin 1.5 të nenit 42 të këtij ligji dhe duke treguar se si do të arrihet shuma e kërkuar e kursimeve. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë mund të bëjë sugjerime për ndryshime gjatë tre (3) muajve pas njoftimit.

8. Kriteret për masat e politikave të ndërmarra në përputhje me nënparagrafin 6.2. i paragrafit 6 të këtij neni përfshijnë si në vijim:

8.1 masat e politikave përcaktojnë së paku dy (2) periudha të ndërmjetme deri më 31 Dhjetor 2020 dhe çojnë në arritjen e cakut;

8.2 përkufizohet përgjegjësia e secilës palë të besuar, palës pjesëmarrëse ose autoritetit publik zbatues, cilado që është relevante;

8.3 sasia e kursimeve të energjisë që kërkohet ose që duhet të arrihet me masën e politikave shprehet qoftë në konsumin përfundimtar qoftë atë primar të energjisë.

8.4. kursimet e energjisë llogariten duke përdorur metodat dhe parimet e parashikuara në paragrafin 1.5 të nenit 42 të këtij ligji.

8.5. një raport vjetor i kursimeve të energjisë që janë arritur do të sigurohet nga palët pjesëmarrëse, përveç nëse nuk është e mundur dhe i njëjti do të bëhet publik.

8.6. sigurohet monitorimi i rezultateve dhe parashikohen masat e duhura nëse progresi nuk është i kënaqshëm.

8.7. është vendosur një sistem kontrolli që përfshin gjithashtu verifikimin e pavarur të përqindjes së duhur statistikore të masave për përmirësimin e efijencës së energjisë. dhe;

8.8. të dhënat mbi trendet vjetore të kursimeve të energjisë publikohen çdo vit.

9. Ministria siguron se kur ka mbivendosje të ndikimit të masave të politikave apo vendimeve individuale, nuk bëhet numërimi i dyfishtë i kursimeve të energjisë.

10. AKEE do të zhvillojë një plan tre (3) vjeçar të zbatimit të skemës së detyrimeve dhe ia dorëzon atë Ministrisë. Plani mund të rishikohet çdo vit sipas nevojës. AKEE do të administrojë Skemën Obligative të Efijencës së Energjisë, do të vendos sistem kontrolli, raportimi, matjeje dhe verifikimi dhe do te raportojë në Ministri.

11. Ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë do të jetë përgjegjëse për funksionimin e duhur të Skemës së Detyrimeve të Efijencës së Energjisë.

12. Në bazë të propozimit të Ministrisë, Qeveria do të aprovojë legjislacionin sekondar që përkufizon së paku:

12.1. përqindjen e caktuar kumulativ që do të arrihet përmes masave alternative dhe përqindjes që do të alokohet për palët e detyruara;

12.2. listën e palëve të detyruara së bashku me cakun kumulativ të alokuar për çdo palë të detyruar.

12.3. përzgjedhja e palëve të detyruara do të bazohet në kriteret transparente dhe jodiskriminuese duke përfshirë vëllimin e energjisë së trajtuar nga të gjitha palët e detyruara.

12.4. detyrimet e palëve të detyruara në lidhje me raportimin dhe lehtësimin e kontrollit, matjes dhe verifikimit nga AKEE.

12.5. procedurat sipas të cilave një palë e detyruar mund të blejë pjesërisht ose plotësisht detyrimin e saj duke transferuar tek FKEE shumën korresponduese me një normë të sheshtë për Ktoe të përcaktuar nga Qeveria.

12.6. mënyrën e kontrollit, matjes, verifikimit dhe raportimit nga AKEE.

12.7. veprimet dhe procedurat që do të ndërmerren nga Ministrinë përgjegjëse për të siguruar se Palët e Detyruara kompensojnë FKEE për kursimet e paarritura të energjisë.

13. Nëse ndryshojnë rrethanat, Ministria përgjegjëse për energji mund të ndryshojë Planin e përcaktuar në paragrafin 10 të këtij neni.

**Neni 11****Auditimet e Energjisë dhe Sistemet e Menaxhimit të Energjisë**

1. AKEE, bazuar në PKVEE, zhvillon programe informimi mbi përfitimet që sjellë menaxhimi i energjisë dhe inkurajon NVM-të që t'i nënshtrohen auditimeve të energjisë dhe zbatimit pasues të rekomandimeve nga këto auditime. Në bazë të kriterëve transparente dhe jodiskriminuese dhe pa paragjykuar Ligjin për Ndhmën Shtetërore, Qeveria e Kosovës, përmes AKEE ose FKEE nga PKVEE, mund të krijojë skema mbështetëse për NVM-të, përfshirë nëse kanë lidhur marrëveshje vullnetare, për mbulimin e kostove të auditimit të energjisë që do të kryhen nga auditorët e pavarur të regjistruar në regjistrin e auditorëve të AKEE-së, dhe të zbatimit të rekomandimeve kost-efektive nga auditimet e energjisë, nëse zbatohen masat e propozuara si dhe për t'i zbatuar sistemet e menaxhimit të energjisë duke ndjekur parimet e standardeve ndërkombëtare për menaxhimin e energjisë deri në masën që kjo është teknikisht e realizueshme, dhe kost-efektive.

2. Ndërmarrjet që nuk janë NVM janë subjekt i një auditimi të energjisë të kryer në mënyrë të pavarur dhe kost-efektive nga auditori i regjistruar i energjisë ose ekipi i auditorëve, sipas nevojës, deri më 5 nëntor 2018 dhe së paku çdo tri (3) vite nga data e auditimit paraprak të energjisë. Auditimi i energjisë duhet t'i plotësojë kriteret minimale në bazë të paragrafit 2.12 të nenit 12 të këtij ligji.

3. Qeveria e Kosovës do t'i inkurajojë ndërmarrjet e cekura në paragrafin 2 të këtij neni që të krijojnë një sistem të menaxhimit të energjisë dhe/ose mjedisit të certifikuar nga një organ i pavarur sipas standardeve përkatëse evropiane ose ndërkombëtare. Në këtë rast, këto ndërmarrje përjashtohen nga kërkesat e paragrafit 2 të këtij neni, me kusht që sistemi i menaxhimit në fjalë përfshin një auditim të energjisë në bazë të kriterëve minimale të bazuara në paragrafin 2.12 të nenit 12 të këtij ligji.

4. Ndërmarrjet e cekura në paragrafin 2 të këtij neni dhe që nuk kanë krijuar një sistem të certifikuar të menaxhimit të energjisë dhe/ose mjedisit sipas paragrafit 3 të këtij neni, duhet t'i zbatojnë detyrimet e mëposhtme:

4.1. të caktojnë një menaxher të energjisë me kualifikime të duhura teknike në fushën e energjisë;

4.2. të krijojnë një strukturë të përshtatshme organizative për menaxhimin e energjisë në biznes dhe objekte;

4.3. të zhvillojnë dhe operojnë një sistem për monitorimin e konsumit të energjisë brenda bizneseve dhe ose objekteve;

4.4. raporti përfundimtar për AKEE lidhur me auditimet e kryera të energjisë, konsumin e energjisë, masat e efiçencës së energjisë të zbatuara dhe kursimet e arritura të energjisë vitin paraprak, do të dorëzohet më së voni deri më 31 Mars të çdo viti.

5. Ministria, me akt nënligjor, publikon listën e parë të ndërmarrjeve nga paragrafi 2 i këtij neni dhe përcakton kërkesat minimale që duhet të përmbushen nga këto ndërmarrje në lidhje me procedurat e menaxhimit të energjisë dhe kërkesat e raportimit. Kjo listë rishikohet çdo vit deri më 31 Maj.

6. Auditimi i energjisë i përcaktuar si në paragrafët 2 ose 3 të këtij neni mund të jetë si raport



i veçantë ose si pjesë e një vlerësimi më të gjerë mjedisor. Aty ku është e mundur, auditimi i energjisë duhet të përfshijë si një pjesë të veçantë një vlerësim të fizibilitetit teknik dhe ekonomik të lidhjes me një rrjet ekzistues ose të planifikuar të ngrohjes ose ftohjes.

7. Pa paragjykuar Ligjin për Ndhimën Shtetërore, Qeveria e Kosovës, përmes AKEE ose FKEE, mund të zbatojë skema nxitëse dhe mbështetëse për ndërmarrjet në paragrafin 2 të këtij neni për zbatimin e rekomandimeve nga auditimet energjetike dhe masat e ngjashme.

8. AKEE dhe ose autoritetet kompetente, varësisht nga madhësia dhe natyra e investimeve në eficiency të energjisë, mund të kërkojnë auditime të detyrueshme të energjisë nga auditorë i regjistruar të energjisë në bazë të kriterëve minimale të përcaktuara në paragrafin 4. të nenit 12 të këtij ligji, në rast të projekteve të eficiency së energjisë në sektorin publik apo privat të financuara tërësisht ose pjesërisht nga buxheti i shtetit ose buxhetet e autoriteteve të administratës publike lokale ose FKEE.

## **Neni 12**

### **Auditorët e Energjisë dhe Auditimi i Energjisë**

1. Auditimi i energjisë kryhet nga auditor i pavarur i energjisë ose një ekip auditorësh, të regjistruar në një regjistrë elektronik të përditësuar rregullisht të AKEE-së.

2. AKEE është përgjegjëse për menaxhimin e tërë skemës së auditimit të energjisë, që do të përcaktohet përmes legjislacionit sekondar për auditorët e energjisë dhe auditimin e energjisë, që do të miratohet nga ministri, dhe do të rregullojë së paku si në vijim:

2.1. kërkesat e trajnimit për kualifikim dhe/ose certifikim ose akreditim të auditorëve të energjisë, duke përfshirë kërkesat dhe mënyrën e mbajtjes së provimeve përfundimtare.

2.2. metodën dhe procedurat për krijimin dhe mirëmbajtjen e një regjistri elektronik të auditimeve të energjisë dhe auditorëve të energjisë.

2.3. kërkesat dhe procedurat për regjistrimin e auditorëve të kualifikuar të energjisë në regjistrin elektronik të AKEE-së.

2.4. kodi i mirësjelljes i auditorëve të energjisë.

2.5. detyrimet e auditorëve lidhur me raportimin në AKEE.

2.6. metodat dhe procedurat për kontrollin e cilësisë së raporteve të auditimit të energjisë dhe auditorëve të energjisë, bazuar në kontrollin e një mostre të raporteve të auditimit të energjisë që ata e realizojnë.

2.7. arsyet dhe procedurat për heqjen nga regjistri i auditorëve për shkak të performancës së dobët dhe/ose shkeljes së kodit të mirësjelljes.

3. Auditimet e energjisë duhet të jenë të cilësisë së lartë, kosto-efektive dhe të kryhen në mënyrë të pavarur nga auditorë të energjisë të kualifikuar dhe të regjistruar që angazhohen për këtë qëllim ose i përkasin personelit të brendshëm, me kusht që të jenë auditorë të regjistruar të energjisë.

4. Me qëllim të garantimit të cilësisë së lartë të auditimeve të energjisë dhe sistemeve të menaxhimit të energjisë, Ministria përcakton kriterë minimale transparente dhe jodiskriminuese

për auditime të energjisë, në bazë të aktit nënligjor sipas paragrafit 1.6 të nenit 42 të këtij ligji, mbi modelet, udhëzimet dhe dokumentet tjera të nxjerra nga AKEE si dhe kërkesat specifike të cilat mund të nxirren nga institucionet që financojnë/përkrahin investimet relevante në efizienzë të energjisë.

5. Auditimet e energjisë nuk do të përfshijnë dispozita që pengojnë gjetjet e auditimit pas transferimit të një ofruesi të shërbimeve të energjisë, me kusht që klienti/konsumatori të mos ketë vërejtje për këtë.

### **Neni 13**

#### **Disponueshmëria e Menaxhimit të Energjisë dhe skemat tjera të kualifikimit, akreditimit dhe të certifikimit**

1. AKEE mund të miratojë dhe përkufizojë përmes PKVEE masa që nxisin disponueshmërinë e skemave të certifikimit për Sistemet e Menaxhimit të Energjisë. Mund të promovohen skema të tjera të kualifikimit, akreditimit dhe certifikimit, duke përfshirë trajnimet për ofruesit e shërbimeve, menaxherët e energjisë, instaluesit e elementeve të ndërtimit të energjisë dhe aktorët e tjerë të tregut të energjisë për t'i rritur kapacitetet, vënë në dispozicion shërbime të besueshme për konsumatorët dhe për të kontribuar në përmbushjen e objektivave kombëtare të efizienzës së energjisë.

2. Skemat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni bëhen të disponueshme për publikun, duke përfshirë masat e duhura për rritjen e vetëdijësisë.

### **Neni 14**

#### **Informatat dhe trajnimet**

1. AKEE do të marrë veprime të duhura për të promovuar dhe lehtësuar përdorimin eficient të energjisë nga konsumatorë të vegjël të energjisë, përfshirë konsumatorët familjarë. Këto mund të përfshijnë ofrimin e informatave lidhur me stimulimet fiskale në dispozicion, qasjen e mundshme në financa, grante apo subvencione, projektet ekzemplare, mënyrat dhe mjetet për arritjen e ndryshimeve kost-efektive dhe të lehta në përdorimin e energjisë dhe informata të tjera relevante.

2. AKEE do të ndërmarrë veprime të duhura për të siguruar që informatat mbi mekanizmat e disponueshëm të efizienzës së energjisë dhe kornizat financiare dhe ligjore janë transparente dhe se shpërndahen përgjithësisht të gjithë aktorët relevantë të tregut, siç janë konsumatorët, ofruesit e shërbimeve energjetike, ndërtuesit, arkitektët, inxhinierët, auditorët mjedisorë dhe të energjisë, instaluesit e elementeve të ndërtimit, siç kërkohet.

3. AKEE do të ndërmarrë veprime të duhura për të siguruar informata për bankat dhe institucionet e tjera financiare mbi mundësitë e pjesëmarrjes, përfshirë partneritetet publike-private në masat e financimit të efizienzës së energjisë.

4. AKEE, në bashkëpunim me palët e interesit, operatorët e tregut dhe autoritetet e administratës publike lokale, do të ndërmarrë veprime ndërgjegjësimi dhe, sipas nevojës, trajnime për qytetarët mbi përparësitë dhe aspektet praktike të ndërmarrjes së masave të efizienzës.

## **Neni 15**

### **Shërbimet e energjisë**

1. Shërbimet e energjisë do të kryhen nga instalues të pajisjeve të kompanive të specializuara të shërbimit të energjisë (ESCO), kompani të ndërtimit, kompani të ngrohjes, auditorët, vlerësuesit e ndërtesave të regjistruara në ministrinë përgjegjëse për regjistrimin e bizneseve, ose çdo anëtar të Bashkimit Evropian ose cilado palë e Komunitetit të Energjisë.

2. Kompanitë e specializuara në shërbimet e energjisë (ESCO), në rast të kontraktimit të zbatimit të masave të efikasitetit të energjisë, do të përfshijnë në kontratat e tyre, së paku:

2.1. vendosjen e qartë të gjendjes referuese, para investimit në bazë të të cilës do të maten dhe verifikohen kursimet e energjisë.

2.2. listën e qartë dhe transparente të masave të efikasitetit të energjisë që duhet të realizohen ose rezultatet e efikasitetit të energjisë që do të arrihen.

2.3. kursimet e garantuara që do të arrihen duke realizuar masat e kontratës.

2.4. kohëzgjatjen dhe fazat e kontratës, afatet dhe periudha e njoftimit.

2.5. listën e qartë dhe transparente të detyrimeve të secilës palë kontraktuese.

2.6. datë(at) e referencës për të vendosur kursimet e arritura.

2.7. listën e qartë dhe transparente të hapave që duhet kryer për të zbatuar një masë ose pako masash dhe, sipas nevojës, shpenzimet përkatëse.

2.8. detyrimin për të zbatuar në tërësi masat në kontratë dhe dokumentimin e të gjitha ndryshimeve të bëra gjatë projektit.

2.9. rregulloret që specifikojnë përfshirjen e kërkesave ekuivalente në çdo nënkontraktim me palët e treta.

2.10. paraqitjen e qartë dhe transparente të implikimeve financiare të projektit dhe shpërndarjen e pjesëmarrjes së të dy palëve në kursimet e arritura monetare siç është kompensimi i ofruesit të shërbimit.

2.11. dispozita të qarta dhe transparente për matjen dhe verifikimin e kursimeve të garantuara, kontrollet e cilësisë dhe garancitë.

2.12. dispozitat që qartësojnë procedurën për të trajtuar ndryshimin e kushteve të kornizës që ndikojnë në përmbajtjen dhe rezultatin e kontratës, ndryshimin e çmimeve të energjisë, intensitetin e përdorimit të një instalimi.

2.13. informata të hollësishme mbi detyrimet e secilës palë kontraktuese dhe ndëshkimet për shkeljen e tyre.

3. AKEE do të publikojë në faqen e saj të internetit:

3.1. praktikat më të mira për kontraktimin e performancës së energjisë, udhëzimet, kontratat model përfshirë klauzolat që duhet të përfshihen në kontrata të tilla për të garantuar kursimet e energjisë dhe të drejtat e konsumatorëve fundorë;

3.2. listën e ofruesve të regjistruar të shërbimeve të energjisë, që duhet të përditësohet rregullisht;

3.3. çdo instrument financiar në dispozicion, stimulimet, grantet dhe kreditë për të mbështetur projektet e shërbimit të efiçencës së energjisë.

4. AKEE do të sigurojë një shqyrtim cilësor në kuadër të PKVEE lidhur me zhvillimin aktual dhe të ardhshëm të tregut të shërbimeve energjetike.

5. Ministria, me mbështetje të AKEE, do të identifikojë barrierat rregullative dhe jorregullative që pengojnë kontraktimin e performancës së energjisë dhe modeleve të tjera të shërbimeve të efiçencës së energjisë, si për sektorin publik ashtu dhe atë privat. Ministria do t'i propozojë Qeverisë së Kosovës miratimin e nevojshëm të akteve nënligjore me qëllim të heqjes së këtyre barrierave dhe të mundësojë kontraktimin e performancës së energjisë, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik.

6. Operatorët e sistemit të transmetimit, shpërndarësit e energjisë dhe furnizuesit e energjisë me pakicë, janë të detyruar të përmbahen nga çdo aktivitet që mund të pengojë kërkesën dhe ofrimin e shërbimeve energjetike ose masave të tjera të përmirësimit të efiçencës së energjisë, ose pengojnë zhvillimin e tregjeve për shërbime apo masa të tilla, duke përfshirë mbylljen e tregut për konkurrentët ose abuzimin e pozitave dominuese.

## **Neni 16**

### **Matja**

1. Konsumi i konsumatorëve fundorë që përdorin energji elektrike, gaz natyror ose energji termike duhet të matet me njehsorë individualë që reflektojnë saktë konsumin aktual të energjisë dhe japin informata mbi kohën aktuale të përdorimit, për aq sa është teknikisht e realizueshme, financiarisht e arsyeshme dhe proporcionale me kursimet e energjisë. Njehsorët e tillë gjithmonë do të instalohen në çmime konkurruese kur:

1.1. matësi ekzistues zëvendësohet;

1.2. bëhet një lidhje e re në një ndërtesë të re ose në ndërtesë që i nënshtrohet rinovimit të madh siç përcaktohet në Ligjin për Performancën e Energjisë në ndërtesa.

2. Në rast kur matja bëhet përmes matësit inteligjent dhe kur vendoset matësi inteligjent, konsumatorët fundorë informohen për kohën aktuale të përdorimit dhe objektivat dhe përfitimet e efiçencës së energjisë, veçanërisht në lidhje me potencialin e plotë lidhur me menaxhimin e leximit të njehsorëve dhe monitorimin e konsumit të energjisë.

3. Me kërkesë të konsumatorit fundor që konsumon energjinë elektrike, operatorët e njehsorit duhet të sigurojnë që njehsori mund të llogarisë energjinë elektrike të vendosur në rrjet nga objekti i konsumatorëve fundorë dhe të vihet në dispozicion të tyre në format lehtësisht të kuptueshëm.

4. Nëse energjia termike në formë të ngrohjes dhe ftohjes ose uji i nxehtë furnizohet për një

ndërtesë nga një rrjet i energjisë termike ose nga një burim qendror që i shërben ndërtesave të shumëfishta, njehsori i ngrohjes apo i ujit të ngrohtë do të instalohet në pikën e shkëmbimit të ngrohjes ose pikën e dërgesës.

5. Në ndërtesa me shumë apartamente dhe shumëqëllimëshe me burim qendror të ngrohjes/ftohjes ose të furnizuara nga rrjeti i ngrohjes qendrore ose nga një burim qendror që i shërben ndërtesave të shumëfishta, njehsorët individualë të konsumit, përfshirë njehsimin me alokues të kostos së ngrohjes, do të instalohen në pajtim me Ligjin për Energjinë Termike. Rregullat për shpërndarjen e kostos së konsumit të ujit të nxehtë në ndërtesat e tilla, të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji, sigurojnë transparencë dhe saktësi të kontabilitetit për konsum individual.

6. Nëse përdorimi i matësve individualë nuk është teknikisht ose financiarisht i zbatueshëm, shpërndarësit individualë të kostos së ngrohjes do të përdoren për matjen e konsumit të ngrohjes në çdo radiator, përveç nëse dëshmohet se instalimi i tillë nuk do të ishte kosto-efikas. Në ato raste mund të merren në konsideratë metoda alternative kosto-efikase për matjen e konsumit të nxehtësisë.

7. Prokurimi, instalimi, operimi, mirëmbajtja dhe zëvendësimi i njehsorëve të tillë do të kryhet në përputhje me Kodin e Matjes, siç kërkohet me Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Energjinë Termike.

## **Neni 17**

### **Informatat e faturimit**

1. Konsumatorët fundorë, të cilët nuk kanë njehsorë të mençur, duhet të marrin informata të faturimit që janë të sakta dhe të bazuara në konsumin aktual, sipas udhëzimit administrativ të përcaktuar në paragrafin 1.7 të nenit 42 të këtij ligji, për të gjithë sektorët e mbuluar me këtë ligj, duke përfshirë shpërndarësit e energjisë, operatorët e sistemit të shpërndarjes dhe kompanitë e shitjes me pakicë të energjisë, nëse kjo është teknikisht e mundshme dhe ekonomikisht e arsyeshme. Ky detyrim mund të përmbushet nga një sistem i vetëleximit të rregullt nga konsumatorët fundorë ku ata i komunikojnë leximet nga matësi njehsori i tyre tek furnizuesi i energjisë. Faturimi mund të bazohet në konsumin e vlerësuar, ose në normë të sheshtë, vetëm nëse konsumatori fundor nuk ka siguruar lexim të matësit njehsori për një interval të caktuar faturimi.

2. Konsumatorët fundorë do të kenë mundësinë për qasje të lehtë përmes internetit ose interfejsit të njehsori në informata plotësuese mbi konsumin historik duke lejuar kontrole të detajuara vetanake. Konsumi i tillë historik përfshin:

2.1. të dhëna kumulative për së paku tri (3) vitet e mëparshme që korrespondojnë me intervalet për të cilat janë prodhuar informatat e vazhdueshme të faturimit; dhe

2.2 të dhëna të hollësishme ditore, javore, mujore dhe vjetore sipas kohës së përdorimit për periudhën e së paku njëzet e katër (24) muajve të mëparshëm ose periudhën që nga fillimi i kontratës së furnizimit, nëse kjo është më e shkurtër.

3. Pavarësisht asaj nëse njehsorët e mençur ekzistojnë apo jo, nëse faturimi i energjisë dhe konsumi historik i konsumatorëve fundorë është në dispozicion, me kërkesë të konsumatorit fundor, informatat e tilla do të vihen në dispozicion të ofruesit të shërbimit të energjisë të caktuar nga konsumatori fundor. Konsumatorëve fundorë u ofrohet mundësia e informimit elektronik lidhur me faturimin dhe faturat që i marrin, të kenë shpjegime të qarta dhe të kuptueshme se si

janë nxjerrë faturat e tilla si dhe llogari gjithëpërfshirëse të kostove aktuale të energjisë, bazuar në nënparagrafin 1.7 të nenit 42 të këtij ligji.

4. Furnizuesit e energjisë duhet t'u ofrojnë konsumatorëve të tyre aranzhime fleksibile për pagesat aktuale dhe sipas kërkesës, do t'u sigurojnë konsumatorëve informata të sakta dhe në kohë dhe vlerësime mbi energjinë që konsumojnë.

#### **Neni 18**

##### **Kostoja e qasjes në informatat e matjes dhe faturimit**

1. Konsumatorët e fundit do t'i marrin të gjitha informatat e tyre të faturave dhe faturimit për konsumimin e energjisë dhe do të kenë qasje në të dhënat e tyre të konsumit në mënyrë adekuate dhe pa pagesë.

2. Shpërndarja e kostove të informatave mbi faturimin për konsumin individual të ngrohjes dhe ftohjes në ndërtesa me shumë njësi banimi dhe me shumë qëllime duhet të kryhet në baza jofitimprurëse. Në rast se kjo detyrë i delegohet një pale të tretë, siç është furnizuesi lokal i shërbimeve të energjisë, kostot që rrjedhin nga matja, ndarja dhe llogaritja e konsumit aktual individual në ndërtesa të tilla mund të konsiderohen të bartura përmes kostove të ngarkuara te konsumatorët fundorë në masën që këto kosto janë të arsyeshme dhe të bazuara në Rregullat e Çmimeve të Energjisë Termike të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

#### **KREU IV**

##### **EFIÇIENCA E ENERGJISË NË FURNIZIMIN E ENERGJISË**

#### **Neni 19**

##### **Promovimi i efijencës në ngrohje dhe ftohje**

1. Me qëllim të promovimit të efijencës së energjisë në ngrohje dhe ftohje, duke përfshirë bashkëprodhimin me efijencë të lartë, Ministria bën vlerësimin gjithëpërfshirës të potencialit për aplikimin e bashkëprodhimit me efijencë të lartë, si dhe të efijencës së ngrohjes dhe ftohjes deri më 30 Nëntor 2018. Elementet dhe kërkesat e vlerësimit të tillë përcaktohen në bazë të aktit nënligjor sipas paragrafit 1.8 të nenit 42 të këtij ligji.

2. Vlerësimi sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të bazohet në analizën e kostove dhe benefiteve dhe duhet të marrë parasysh kushtet klimatike, fizibilitetin ekonomik dhe përshtatshmërinë teknike ashtu që të identifikojë zgjidhje efijente për të përmbushur nevojat për ngrohje dhe ftohje. Ministria përgjegjëse për energji do të përgatit dhe harton metodologji për analizën e kostove dhe benefiteve që përputhet me kërkesat e aktit nënligjor sipas paragrafit 1.9 të nenit 42 të këtij ligji, brenda 3 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Nëse vlerësimi i cekur në paragrafin 1 të këtij neni dhe analizat e cekura në paragrafin 2 të këtij neni identifikojnë një potencial në aplikimin e ngrohjes dhe ftohjes me efijencë të lartë dhe ose ftohjes efijente, përfitimet e të cilave tejkalojnë shpenzimet, Ministria i propozon Qeverisë marrjen e masave adekuate, sipas nevojës, për mbështetjen dhe zhvillimin e infrastrukturës së ngrohjes dhe ftohjes qendrore efijente, të bashkëprodhimit kogjenerimit me efijencë të lartë nga djegia nxehtësia e biomasës dhe burime të tjera të mbeturinave dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë. Për këtë qëllim, Ministria do të bashkëpunojë ngushtë me autoritetet komunale përgjegjëse për çështjen e efijencës.

4. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, investitorët dhe ose operatorët e instalimeve, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, duhet të kryejnë analizën kosto-efektive të nivelit të instalimit, sa herë që ka:

4.1. plan për stabilimente të reja për prodhimin e energjisë termike, centralet e reja të energjisë termike me fuqi hyrëse termike mbi 20 MW, për të vlerësuar kost-benefitin e funksionimit të centralit si central me eficiency të lartë të bashkëprodhimit;

4.2. rinovim substancial të termocentraleve ekzistuese me kontribut të përgjithshëm të energjisë prej mbi 20 MW, për të vlerësuar kost-benefitin e konvertimit të tij në central bashkëprodhimi me eficiency të lartë;

4.3. plan për ndërtimin e një centrali industrial me kontribut total të energjisë termike mbi 20 MW, i cili gjeneron nxehtësi që humbet me temperaturë të përdorshme ose nëse centrali i tillë i nënshtrohet një rinovimi të konsiderueshëm, për të vlerësuar kost-benefitin e përdorimit të energjisë së humbur për të plotësuar kërkesat ekonomikisht të arsyeshme, përfshirë zbatimin e bashkëprodhimit dhe lidhjes në largësi të instalimit në rrjetin e ngrohjes dhe ftohjes;

4.4. plan për ndërtimin e një rrjeti të ri të ngrohjes dhe ftohjes nga distanca, ose kur në rrjetin ekzistues të ngrohjes dhe ftohjes, ekziston një plan për ndërtimin e gjeneratorit të ri të energjisë me një input të fuqisë termike prej mbi 20 MW ose instalimi i tillë ekzistues është planifikuar për rinovim substancial për të vlerësuar kost-benefitin e përdorimit të ngrohjes të humbur nga instalimet industriale fqinje.

5. Dispozitat e paragrafit 4 të këtij neni nuk zbatohen për:

5.1. termocentralet me ngarkesë të pikut dhe centralet rezervë të cilat do të operojnë nën njëmijë e pesëqind (1500) orë në vit si një mesatare periodike për një periudhë prej pesë (5) vitesh, bazuar në procedurën e monitorimit të caktuar nga Ministria, për të siguruar që ky kriteri i përjashtimit është plotësuar;

5.2. instalimet e vendosura afër një lokacioni të deponisë gjeologjike të dioksidit të karbonit.

6. Zyra e Rregullatorit për Energji siguron që Rregullorja për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja të prodhimit përmban kriteret e autorizimit që marrin parasysh:

6.1. rezultatin e vlerësimit gjithëpërfshirës të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni;

6.2. rezultatin e analizës së kostos-benefitit të cekur në paragrafin 2 të këtij neni, dhe

6.3. kërkesat e paragrafit 4 të këtij neni.

7. Certifikimi i origjinës së energjisë elektrike të prodhuar nga bashkëprodhimi me eficiency të lartë garantohet sipas kriterëve objektive, transparente dhe jodiskriminuese sipas aktit nënligjor të paragrafit 1.10 të nenin 42 të këtij ligji.

## Neni 20

### Transformimi, transmetimi dhe shpërndarja e energjisë

1. Zyra e Rregullatorit për Energji duhet kushtojë vëmendje të duhur masave të efijencës së energjisë në lidhje me infrastrukturën e gazit dhe energjisë elektrike. Gjatë zhvillimit të tarifave dhe rregulloreve të rrjetit, Zyra e Rregullatorit për Energji do të marrë parasysh kostot dhe përfitimet e secilës masë dhe do të ofrojë stimuj për operatorët e rrjetit në lidhje me masat për përmirësimin e efijencës së energjisë në kontekstin e vendosjes së vazhdueshme të rrjeteve të mençura.

2. Zyra e Rregullatorit për Energji siguron që kodet e rrjetit elektrik dhe tarifat e rrjetit përmbushin kriteret e bazuara në aktin nënligjorë siç përcakohet në paragrafin 1.11 të nenit 42 të këtij ligji.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit siguron jo më vonë se 31 dhjetor 2018, që :

3.1. është ndërmarrë vlerësimi për potencialet e efijencës së energjisë të infrastrukturës së gazit dhe energjisë elektrike, në veçanti në lidhje me transmetimin, shpërndarjen, menaxhimin e ngarkesës dhe interoperabilitetion dhe lidhjen me instalimet e prodhimit të energjisë, duke përfshirë edhe qasjen për prodhuesit e vegjël; dhe

3.2. janë identifikuar masat konkrete dhe investimet për futjen e përmirësimeve kosto-efektive të efijencës së energjisë në infrastrukturën e rrjetit, me afat kohor për futjen e tyre.

4. Zyra e Rregullatorit për Energji siguron që operatorët e rrjetit stimulohen për të përmirësuar efijencën në hartimin dhe operimin e infrastrukturës dhe se tarifat u mundësojnë furnizuesve të përmirësojnë pjesëmarrjen e konsumatorëve në efijencën e sistemit, duke përfshirë përgjigjen e kërkesës, varësisht nga rrethanat kombëtare. Gjithashtu, ajo siguron që operatorët e sistemit të transmetimit dhe operatorët e sistemit të shpërndarjes ofrojnë qasje prioritare ose të garantuar në rrjetin e energjisë elektrike nga bashkëprodhimi me efijencë të lartë dhe dispeçim prioritare të energjisë elektrike nga bashkëprodhimi me efijencë të lartë, për sa kohë që lejon operimi i sigurt i sistemit kombëtar të energjisë elektrike.

5. Zyra e Rregullatorit për Energji miraton dhe publikon rregullat që rregullojnë renditjen e prioriteteve të ndryshme të qasjes dhe dispeçimit të prioriteteve për llojet e ndryshme të energjisë së ripërtëritshme dhe bashkëprodhimit me efijencë të lartë dhe veçanërisht lehtëson lidhjen me sistemin e rrjetit të energjisë elektrike të prodhuar nga bashkëprodhimi me efijencë të lartë nga njësitë e vogla dhe mikro të bashkëprodhimit.

6. Kur kjo është teknikisht dhe ekonomikisht e mundshme, operatorët e bashkëprodhimit me efijencë të lartë mund të ofrojnë shërbime balancimi dhe shërbime të tjera operationale në nivelin e operatorëve të sistemit të transmetimit ose operatorëve të sistemit të shpërndarjes. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe operatorët e sistemit të shpërndarjes duhet të sigurojnë që këto shërbime janë pjesë e procesit të tenderimit të shërbimeve, në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese.

7. Kur është e përshtatshme, operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes duhet të inkurajojnë që bashkëprodhimi me efijencë të lartë të vendoset pranë zonave të kërkesës duke zvogëluar ngarkesën e lidhjes dhe përdorimit të sistemit.

8. Prodhuesit e energjisë elektrike nga bashkëprodhimi me efijencë të lartë që dëshirojnë të



lidhen me rrjet kanë të drejtë të bëjnë një thirrje për tender për punimet e kycjes.

9. Zyra e Rregullatorit për Energji inkurajon burimet e anës së kërkesës, siç është reagimi ndaj kërkesës, që të marrin pjesë së bashku me anën e ofertës në tregjet me shumicë dhe pakicë. Ajo siguron që operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes, në përmbushjen e kërkesave për balancim dhe shërbime ndihmëse, trajtojnë ofruesit e përgjigjeve të kërkesës, duke përfshirë agregatorët, në mënyrë jodiskriminuese, në bazë të aftësive të tyre teknike.

10. Varësisht nga kufizimet e brendshme teknike në menaxhimin e rrjeteve, Zyra e Rregullatorit për Energji promovon qasjen dhe pjesëmarrjen e përgjigjes së kërkesës në tregjet e balancimit, rezervat dhe shërbimet e tjera të sistemit, ndër të tjera duke kërkuar operatorë të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes në bashkëpunim të ngushtë me ofruesit e shërbimeve të kërkesës dhe konsumatorët, për të përcaktuar modalitetet teknike për pjesëmarrjen në këto tregje në bazë të kërkesave teknike dhe aftësive të përgjigjes së kërkesës, duke përfshirë pjesëmarrjen e aggregateve.

## **KREU V ETIKETIMI I ENERGJISË**

### **Neni 21 Etiketimi i Energjisë**

1. Në bazë të propozimit të Ministrisë përgjegjëse për energji dhe Ministrisë përgjegjëse për tregti, Qeveria e Kosovës miraton akte nënligjore që përcaktojnë një kornizë që zbatohet për produkte të lidhura me energji të vendosura në treg ose të futura në shërbim në territorin e Republikës së Kosovës. Aktet nënligjore duhet të përcaktojnë etiketimin e atyre produkteve dhe sigurimin e informacionit standard lidhur me eficiencyn e energjisë, konsumin e energjisë dhe të burimeve tjera nga produkti gjatë përdorimit dhe informata plotësuese lidhur me produktet, dhe në këtë mënyrë t'iu mundësojnë konsumatorëve të zgjedhin produkte më eficiente në mënyrë që të zvogëlojnë konsumin e tyre të energjisë.

2. Në mënyrë që të plotësohen aktet nënligjore sipas paragrafit 1 të këtij neni, Ministria përgjegjëse për energji përcakton kërkesat e hollësishme që kanë të bëjnë me etiketat dhe informacionin për produkte specifike të cilat duhet të jenë në përputhje me këtë ligj.

3. Furnizuesi i produkteve që mbulohen me këtë nen duhet:

3.1. të sigurojë që produktet të cilat janë vendosur në treg janë shoqëruara, për çdo njësi individuale, pa pagesë, me etiketa të sakta të shtypura dhe me fletëinformacion të produktit në përputhje me kërkesat e theksuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

3.2. të sigurojë saktësinë e etiketave dhe fletëinformacionit të produktit që e ofron dhe të hartojë dokumentacion teknik të mjaftueshëm për të mundësuar vlerësimin e saktësisë.

3.3. të veprojë në përputhje me të gjitha kërkesat specifike, siç do të përcaktohen në aktet nënligjore sipas paragrafit 1 të këtij neni.

4. Tregtari i produktit:

4.1. do të shfaqë etiketën e siguruar nga furnizuesi në mënyrë të dukshme, duke

përfshirë atë për shitjet në distancë nëpërmjet interneti, por pa u kufizuar vetëm në internet dhe telemarketing.

4.2. do të vë në dispozicion për konsumatorë fletëinformacionin e produktit duke përfshirë, sipas kërkesës, edhe në formë fizike në pikën e shitjes.

4.3. do të veprojë në përputhje me të gjitha kërkesat specifike siç do të përcaktohen në aktet nënligjore sipas paragrafit 1 të këtij neni.

5. Furnizuesi dhe tregtari bashkëpunojë me autoritetin e mbikëqyrjes së tregut dhe marrin masa të menjëhershme për të korrigjuar çdo rast të mos përputhjes me kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe me kërkesat sipas paragrafit 2 të këtij neni, që bien nën përgjegjësinë e tyre, me nismën e tyre ose kur një gjë e tillë kërkohet nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut

6. Ministria përgjegjëse për tregti duhet të jetë autoriteti i mbikëqyrjes së tregut për të siguruar zbatimin e dispozitave të këtij neni.

7. Aktet nënligjore të theksuara në paragrafin 1 të këtij neni përcakton në hollësi si në vijim:

7.1. çdo kërkesë specifike lidhur me detyrimet e furnizuesve dhe tregtarëve, nëse është e nevojshme;

7.2. mënyrën e realizimit të aktiviteteve edukative dhe/ose promovuese dhe informuese, siç mund të kërkohen;

7.3. kërkesat për raportim në lidhje me etiketimin e energjisë;

7.4. mënyrën e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimin e informacionit për mbikëqyrjen dhe kontrollin e tregut;

7.5. procedurat në nivel kombëtar për trajtimin e produkteve që paraqesin rrezik për mos pajtueshmëri me këtë ligj;

7.6. mënyrën për të ruajtur bashkëpunimin ndërkombëtar lidhur me produktet që konstatohet se nuk janë në pajtueshmëri;

7.7. mënyrën e përcaktimit të kërkesave të theksuara në paragrafin 2 të këtij neni;

7.8. dispozita tjera, siç kërkohet.

8. Ministria e Financave, në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, harton një udhëzim administrativ mbi lehtësirat financiare për produktet me efiçencë të lartë të energjisë.

## **KREU VI** **AGJENCIA E KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË**

### **Neni 22** **Agjencia e Kosovës për Efiçencë të Energjisë**

1. Agjencia e Kosovës për Efiçencë të Energjisë është organi qendror i administratës shtetërore

përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të eficiencës së energjisë.

2. AKEE financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Selia e AKEE është në Prishtinë.

### **Neni 23**

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë e AKEE**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e AKEE janë:

1.1. kryerja ose kontraktimi i analizave, dhe rekomandimi i politikave për promovimin e eficiencës së energjisë;

1.2. hartimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë;

1.3 Propozon akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji;

1.4. harton manuale, udhëzime, rregulla teknike për eficiencë të energjisë në pajtim me legjislacionin në fuqi;

1.5 grumbullimi i të dhënave nga institucionet relevante publike për rezultatet e testimit dhe matjes në pajtim me standardet kombëtare të eficiencës së energjisë sipas legjislacionit në fuqi;

1.6 vlerësimi teknik i projekteve të eficiencës së energjisë të financuara nga FKEE, nëse kërkohet në pajtim me paragrafin 2 të nenit 37 të këtij ligji;

1.7. zhvillimi dhe koordinimi i programeve të ngritjes së kapaciteteve me institucionet relevante;

1.8. funksionimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave për eficiencën e energjisë;

1.9. vlerësimi i përputhshmërisë së Planeve Komunale për Eficiencë të Energjisë me Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencë të Energjisë dhe ofrimi i rekomandimeve për përmirësim, për autoritetet komunale, aty ku është e nevojshme;

1.10. zhvillimi i sistemit të monitorimit të implementimit të Planit të Kosovës për eficiencën e energjisë dhe përmbushjes së caqeve kombëtare indikative për kursim të energjisë;

1.11. hartimi i Raportit të Progresit për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe raportit vjetor mbi progresin e arritur në drejtim të caqeve kombëtare të eficiencës së energjisë;

1.12. mbështetja e komunave në çështjet që kanë të bëjnë me planifikimin dhe promovimin e eficiencës së energjisë dhe zbatimin e programeve të ndryshme për eficiencë të energjisë në nivel komunal;

1.13. koordinimi i zbatimit të programeve për të promovuar eficiency e energjisë, për skemat e detyrueshme për eficiency të energjisë dhe skemat e stimulimit financiar në bashkëpunim me të gjitha strukturat në kuadër të Ministrisë dhe institucioneve të tjera përkatëse;

1.14. mbështetja e përfshirjes së palëve të interesit në zbatimin e masave për rritjen e eficiency së energjisë;

1.15. nxitja e eficiency së energjisë përmes fushatave të ndërgjegjësimit publik në nivel kombëtar, duke përfshirë disponueshmërinë e stimujve dhe skemave të tjera financiare të lidhura me to;

1.16. përgatitja dhe përditësimi i faqes zyrtare të AKEE;

1.17. ngritja dhe menaxhimi i skemës së auditimit të energjisë, si dhe menaxhimi i energjisë dhe skemave të tjera të certifikimit sipas këtij ligji, duke përfshirë trajnimin e auditorëve, regjistrin e auditimeve të energjisë dhe auditorët e energjisë dhe kontrollin e cilësisë sipas nenit 12 të këtij ligji;

1.18. themelimi dhe menaxhimi i skemave të matjes dhe monitorimit të masave të eficiency së energjisë duke përfshirë ato që i referohen nenit 8 të rinovimeve të ndërtesave publike dhe nenit 10 të këtij ligji mbi skemat e eficiency së energjisë;

1.19. Monitorimi i zbatimit të auditimeve të energjisë dhe sistemeve të menaxhimit të energjisë në objektet e konsumit të energjisë sipas nenit 11 të këtij ligji;

1.20. Themelimi dhe mirëmbajtja e një sistemi të qëndrueshëm të monitorimit, verifikimit dhe raportimit për aktivitetet e eficiency së energjisë në vend, si dhe;

1.21. aktivitetet e tjera të përcaktuara me këtë ligj si dhe ligjin për performancën energjetike të ndërtesave dhe ligjet tjera të lidhura me eficiency të energjisë.

2. Organizimi struktura dhe funksionalizimi i brendshëm i AKEE, rregullohet me Rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës për AKEE.

## KREU VII

### FONDI I EFIÇIENCËS SE ENERGJISË DHE PARIMET E TJERA TË FUNKSIONIMIT

#### Neni 24

#### Themelimi dhe i Fondit për Eficiency të Energjisë

Fondi i Kosovës për Eficiency së Energjisë themelohet me këtë ligj si entitet i pavarur, autonom dhe i qëndrueshëm, për të mundësuar që Qeveria e Kosovës të arrijë objektivat politike të saj për eficiency e energjisë përmes promovimit, mbështetjes dhe ose zbatimit të masave të eficiency së energjisë si dhe tërheqjes dhe menaxhimit të burimeve financiare për të financuar dhe zbatuar projektet e investimeve në fushën e eficiency së energjisë në mënyrë të qëndrueshme.

## **Neni 25**

### **Themelimi dhe baza juridike e FKEE**

1. Themeluesi i Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë është Republika e Kosovës, përmes këtij ligji.
2. Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë themelohet me këtë ligj si subjekt i pavarur autonom juridik në shërbim të interesit publik, me personalitet të plotë juridik dhe identitet ligjor që është i veçantë dhe i dallueshëm nga Bordi i Drejtorëve dhe Ekzekutivi i FKEE.
3. Pa u kufizuar si në vijim, FKEE, ka të drejtë të kontrakttojë, padisë dhe të paditet në emër të vet, asetëve të veta, investimeve në projektet e eficiencës së energjisë dhe të pranojë çfarëdo kthimi të investimeve, pranojë dhe lëshojë grante dhe donacione, hua dhe instrumente të tjera financiare për t'i arritur objektivat e saj siç parashihet me këtë ligj.
4. FKEE ka autonomi të plotë operationale dhe administrative dhe funksionon jashtë kornizës së strukturave qeveritare të Kosovës dhe Shërbimit Civil të Kosovës dhe nuk konsiderohet si organizatë buxhetore në kuptim të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë dhe Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
5. Të gjitha të hyrat që FKEE i siguron nga donacionet, kthimet në investime, tarifatat dhe pagesat e tjera të pranuar apo ngarkuar në përputhje me këtë ligj dhe ligjet në fuqi, qeverisen me dispozitat e këtij ligji, dhe aktet nënligjore për FKEE të miratuara nga Qeveria e Kosovës dhe Rregulloret e brendshme në fuqi për përkufizimin e rregullave dhe procedurave operationale të FKEE. Në rast të mospërputhjeve me ligjet tjera në fuqi në lidhje me buxhetin dhe shpenzimet e FKEE, mbizotëron ky ligj.
6. FKEE është përgjegjës për palët e treta me kapital të vet.
7. FKEE ka të drejtë të ketë llogari bankare në bankat e themeluara në Kosovë.
8. FKEE operon në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

## **Neni 26**

### **Përshtatshmëria dhe pajtueshmëria**

1. FKEE nuk financon investime që mund të lidhen me aktivitete të paligjshme ose ndonjë aktivitet tjetër që ndalohet nga legjislacioni në fuqi. Të gjitha instrumentet financiare të mbështetura nga FKEE duhet të jenë në përputhje me standardet e aplikueshme financiare, sociale, shëndetësore dhe mjedisore.
2. Të gjitha investimet e mbështetura nga FKEE duhet të jenë plotësisht në përputhje me rregullat dhe kushtet e instrumenteve financiare përkatëse të përcaktuara nga FKEE.
3. FKEE do të përmbahet rreptësisht dhe do të ndërmarrë masa që parandalojnë dhe luftojnë praktikën mashtruese dhe korruptive.

## **Neni 27** **Bordi i Drejtorëve**

1. Organet e FKEE janë Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori Menaxhues.
2. Bordi i Drejtorëve të FKEE është organi kryesor i qeverisjes së FKEE, përgjegjës për mbikëqyrjen e përgjithshme të FKEE në përputhje me mandatin e tij të parashikuar me këtë ligj edhe aktet nënligjore mbi FKEE-në.
3. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga shtatë (7) anëtarë si në vijim:
  - 3.1. një (1) përfaqësues i emëruar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, si anëtar me të drejtë vote;
  - 3.2. një (1) përfaqësues i emëruar nga Ministria e Financave, si anëtar me të drejtë vote;
  - 3.3. një (1) përfaqësues i emëruar nga Ministria e Administratës Publike, si anëtar me të drejtë vote;
  - 3.4. një (1) përfaqësues i emëruar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës si anëtar me të drejtë vote;
  - 3.5. Drejtori Menaxhues i FKEE si anëtar me të drejtë vote;
  - 3.6. dy (2) anëtarë të pavarur të emëruar nga dy donatorët kryesorë në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore dhe rregulloret e brendshme të FKEE, si anëtarë pa të drejtë vote.
4. Rregulloret e Brendshme të FKEE përcaktojnë mekanizmin për zgjedhjen e Anëtarëve të Pavarur të Bordit në rast se donatorët nuk do të jenë më të përfshirë në FKEE:
5. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve emërohen me mandat tre (3) vjeçar. Pas skadimit të mandatit të Anëtarëve të Bordit, anëtarët ekzistues vazhdojnë të shërbejnë si ushtrues detyre të anëtarëve të bordit deri në zgjedhjen pasuese të anëtarëve dhe themelimit të Bordit të ri.
6. Çdo vendim i Bordit të Drejtorëve merret me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të Bordit.
7. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve duhet të jenë individë që kanë integritet të dalluar, arsimim adekuat dhe së paku pesë (5) vite përvojë profesionale, veçanërisht relevante për aktivitetet e FKEE si financa, ekonomi, inxhinieri apo disiplina të ngjashme.
8. Asnjë Anëtar i Bordit të Drejtorëve nuk do të jetë zyrtar i zgjedhur, i emëruar politik ose person që ka mbajtur pozitë të zgjedhur ose udhëheqëse në cilëndo parti politike në çdo kohë gjatë njëzet e katër (24) muajve të mëparshëm.
9. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve mund të jenë nëpunës civilë përveç dy (2) anëtarëve të pavarur të Bordit të Drejtorëve dhe Drejtorit Menaxhues, të cilët nuk mund të mbajnë pozita të

nëpunësit civil.

10. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve mund të rizgjidhen më së shumti edhe për një mandat tjetër në vazhdim.

11. Në mbledhjen e parë, anëtarët e zgjedhur të Bordit të parë të Drejtorëve, zgjedhin Kryesuesin nga radhët e anëtarëve të tij. Deri kur Bordi i Drejtorëve të emërojë Kryesuesin për të shërbyer në Bordin e Drejtorëve, anëtari më i vjetër i Bordit do të shërbejë si ushtrues detyre i Kryesuesit.

12. Kryesuesi duhet të thërras, kryesojë dhe sigurojë mbarëvajtjen e rregullt të mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve.

13. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve nuk kanë konflikte të interesit dhe ushtrojnë funksionet e veta në mënyrë të pavarur dhe vetëm në interesin më të mirë të FKEE, si dhe në mënyrë profesionale dhe kolegjiale. Anëtarët e Bordit pritet të sjellin ekspertizën dhe njohuritë e specializuara në Bordin e Drejtorëve por në asnjë mënyrë nuk ushtrojnë votën e tyre sipas udhëzimeve apo interesit të ndonjë pale apo grupi interesi. Të gjithë anëtarët mbajnë standardet më të larta të etikës dhe profesionalizmit gjatë tërë mandatit të tyre. Në rastin e jashtëzakonshëm që një anëtar i bordit të drejtorëve mund të ketë arsye personale ose të tjera që mund të perceptohen si konflikt interesi për çështje që kanë të bëjnë me një vendim të veçantë, ai do ta paraqesë rastin e tillë tek bordi i drejtorëve që mund të vendosë për përjashtimin e tij ose saj nga kjo procedurë e veçantë vendimmarrëse

14. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve apo punonjësit e FKEE nuk duhet të lejojnë dhe të pranojnë asnjë përpjekje për të ndërhyrë apo ndikuar në vendimet e tyre gjatë realizimit të detyrave të tyre nga palët e treta dhe janë të obliguar ta informojnë Bordin lidhur me përpjekjet e tilla.

15. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve, Komitetet e Bordit të Drejtorëve, këshilltarët dhe ekspertët do të ruajnë konfidencialitetin e informatave që i sigurojnë gjatë realizimit të detyrave të tyre.

16. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve, me përjashtim të Drejtorit Menaxhues të FKEE-së, marrin kompensim nga FKEE për pjesëmarrje në mbledhjet e Bordit në pajtim me Rregulloret e Brendshme dhe buxhetin e FKEE.

17. Në rastin e jashtëzakonshëm që një anëtar i Bordit të Drejtorëve mund të ketë interes personal ose konflikt interesi për çështje që kanë të bëjnë me një vendim të veçantë, ai ose ajo do të zbulojë një rast të tillë dhe do të përjashtohet nga kjo vendim-marrje e veçantë.

## **Neni 28**

### **Kompetencat e Bordit të Drejtorëve**

1. Bordi i Drejtorëve:

1.1. emëron dhe shkarkon Drejtorin Menaxhues të FKEE bazuar në kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme;

1.2. autorizon Drejtorin Menaxhues për të nënshkruar dhe ekzekutuar Marrëveshje;

1.3. vendos për blerjen, mbajtjen dhe menaxhimin e pronës së FKEE;

1.4. miraton dhe ndryshon Rregulloren e Brendshme siç parashihet në paragrafin 4 dhe 5 të nenit 42 këtij ligji;

1.5. miraton planin trevjeçar (3) të zhvillimit të biznesit të FKEE, planet vjetore të lidhura me treguesit e performancës që lidhen me këto plane, shqyrton progresin e arritjes së treguesve të performancës së paku në baza tremujore, dhe në rast të devijimeve negative urdhëron veprime korigjuese;

1.6. miraton buxhetin vjetor, raportin vjetor dhe pasqyrat vjetore financiare;

1.7. miraton depozitat e fondeve të FKEE në bankat e Kosovës;

1.8. vendos mbi pranueshmërinë e përfituesve të FKEE dhe kriteret e pranueshmërisë për investimet që mund të mbështeten nga FKEE;

1.9. merr vendime për përcaktimin e nivelit të tarifave, pagesave dhe ngarkesave sipas këtij ligji;

1.10. miraton emërimin e auditorëve të jashtëm të FKEE;

1.11. miraton numrin e përgjithshëm të stafit dhe kompensimin e tyre sipas rekomandimeve të Drejtorit Menaxhues të FKEE;

1.12. kompetenca dhe përgjegjësi të tjera të parapara me këtë ligj dhe të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të FKEE;

1.13. bën rekomandime për ndryshimin e plotësimin e këtij ligji bazuar në përvojën operacionale në aplikimin e tij.

## Neni 29

### Shkarkimi i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve

1. Anëtari i Bordit të Drejtorëve shkarkohet nga pozita në bazë dhe sipas dispozitave të këtij Ligji, nëse:

1.1. është i papërshtatshëm apo ka humbur pranueshmërinë për të shërbyer në Bordin e Drejtorëve sipas kërkesave në nenin 27 të këtij ligji;

1.2. është dënuar për vepër penale me vendim të plotfuqishëm të gjykatës me burgim për gjashtë (6) muaj apo më shumë;

1.3. është debitor apo është përfshirë si debitor në procedurë falimentimi apo i falimentuar;

1.4. për shkak të sjelljes të keqe personale, është diskualifikuar apo suspenduar nga një autoritet kompetent nga ushtrimi i profesionit;

1.5. nuk është në gjendje të ushtrorë funksionet e një mandati të tillë për shkak të paaftësisë mendore apo fizike që ka zgjatur për më shumë se gjashtë (6) muaj;



1.6. ka munguar në tri (3) mbledhje të njëpasnjëshme të Bordit të Drejtorëve pa arsyetim të qëndrueshëm.;

2. Anëtari i Bordit të Drejtorëve shkarkohet nga detyra nëse është angazhuar në aktivitete që nuk përputhen me standardet dhe integritetin, në shkelje të Kodit të Etikës së FKEE apo janë të pahijshme për një anëtar të Bordit të Drejtorëve.

3. Procedura dhe procesi i vendimmarrjes për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve duhet të zhvillohet siç specifikohet me Rregulloret e brendshme të FKEE.

4. Çdo anëtar i Bordit ka të drejtë të ofrojë dorëheqje nga pozita e tij me njoftim paraprak prej së paku një muaji. Në rast të dorëheqjes, anëtari i Bordit të Drejtorëve njofton Bordin e Drejtorëve duke e theksuar datën efektive të dorëheqjes së tij.

### **Neni 30**

#### **Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve**

1. Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve kryesohen nga Kryesuesi, apo në mungesën e tij, i emëruari nga Kryesuesi.

2. Bordi i Drejtorëve mbledhet për aq herë sa nevojitet për veprimtarinë e FKEE-së, por jo më pak se katër (4) herë në vit.

3. Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve thirren dhe njoftohen për të gjithë Anëtarët e Bordit nga Kryesuesi, i cili vendos rendin e ditës sipas propozimit të Drejtorit Menaxhues të FKEE.

4. Mbledhjet mund të thirren edhe me kërkesë të shkruar të dy (2) anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.

5. Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve thirren duke komunikuar kohën, vendin dhe rendin e ditës të mbledhjes dhe dokumentacionin e duhur që do të diskutohet tek të gjithë anëtarët e Bordit të Drejtorëve së paku dhjetë (10) ditë pune para datës së caktuar për mbledhje; në raste urgjente, mbledhjet mund të thirren brenda një afati më të shkurtër.

6. Secili anëtar i Bordit të Drejtorëve ka një votë. Në rast të votave të barabarta, vota e Kryesuesit do të jetë vendimtare.

7. Kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe marrjen e vendimeve në secilën mbledhje të Bordit të Drejtorëve arrihet me katër (4) anëtarë të Bordit të Drejtorëve, ku së paku njëri prej të cilëve është Kryesuesi apo i/e emëruari i Kryesuesit.

8. Përveç rasteve të përcaktuara me këtë ligj, vendimet e Bordit të Drejtorëve merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm votues. Megjithatë, mbledhjet dhe votimet me telekonferencë janë të lejuara, por çdo vit mbahen së paku dy mbledhje të Bordit të Drejtorëve me prani personale.

9. Në përputhje me kriterin e kuorunit si më lart, asnjë akt apo procedim i Bordit të Drejtorëve nuk shfuqizohet për shkak të ekzistimit të një apo më shumë vendeve të lira në Bordin e Drejtorëve.

10. Bordi i Drejtorëve mund të ftojë persona si vëzhgues dhe ekspertë në seancat publike

të Bordit, të cilët nuk do të kenë qasje në informata konfidenciale. Vëzhgues të tillë mund të jenë përfaqësues të donatorëve, institucioneve financiare ndërkombëtare, shoqatave, odave ekonomike, grupeve të grave e pakicave, dhe bota akademike. Të ftuarit dhe ekspertët nuk kanë të drejtë votimi por mund të kërkohen dhe të ftohen nga Kryesuesi për t'iu drejtuar Bordit të Drejtorëve.

11. Bordi i Drejtorëve do të themelojë Komitetet e Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut. Komitete të tjera shtesë mund të themelohen nga Bordi i Drejtorëve.

### **Neni 31** **Drejtori Menaxhues**

1. Drejtori Menaxhues i FKEE-së do të jetë edhe Zyrtari Kryesor Ekzekutiv i FKEE-së me orar të plotë, përgjegjës për tërë menaxhimin dhe vendimet operacionale të FKEE. Drejtori Menaxhues i FKEE-së emërohet nga Bordi i Drejtorëve për një mandat trevjeçar (3), me mundësi të riemërimit bazuar në performancën dhe vlerësimin.

2. Drejtori Menaxhues i FKEE duhet të ketë titull universitar në ekonomi, administrim biznesi, inxhinieri apo disiplina të ngjashme që ndërlidhen me veprimtarinë e FKEE. Drejtori Menaxhues i FKEE duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune menaxheriale në financa dhe/ose menaxhment. Ai/ajo duhet ta njohë rrjedhshëm gjuhët zyrtare dhe angleze.

3. Rregullat dhe procedurat e kualifikimit dhe procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes së Drejtorit Menaxhues të Fondit do të përcaktohen me Rregulloret e Brendshme të FKEE.

4. Drejtori Menaxhues merr të gjitha vendimet menaxheriale dhe operative për FKEE dhe është përgjegjës për:

- 4.1. përfaqësim dhe menaxhim të punëve të FKEE-së dhe zbatimin e vendimeve e politikave të Bordit të Drejtorëve;
- 4.2. ofrim të rekomandimeve për Bordin e Drejtorëve në lidhje me përmirësimin e operacioneve të FKEE-së dhe përputhshmërinë me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi;
- 4.3. përgatitje dhe propozim të planit afarist zhvillimor, planeve vjetore dhe planeve financiare, përfshirë nivelin e pagesave dhe ngarkesave, dhe dorëzim të pasqyrave financiare vjetore për miratim;
- 4.4. hartim dhe dorëzim të politikave investuese për miratim;
- 4.5. prezantim të të gjitha veprimeve, rregullave, urdhrave e udhëzimeve të propozuara për miratim nga Bordi i Drejtorëve;
- 4.6. ofrim të rekomandimeve në lidhje me emërimin e auditorit të jashtëm të FKEE-së;
- 4.7. angazhim të personelit në pajtim me këtë ligj;
- 4.8. kryerje të veprimtarive tjera në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme të FKEE.

4.9. monitorim të progresit të veprimtarisë së FKEE dhe përgatitje të raporteve tremujore të progresit për Bordin e Drejtorëve, duke pasqyruar qartë nivelin e të arriturave dhe indikatorët e performancës, arsyet për devijime negative të mundshme nga caqet e planifikuara dhe propozim të veprimeve përkatëse për tejkalim të situatës, në pajtim të plotë me dispozitat e këtij Ligji dhe Rregulloret e Brendshme të Fondit .

5. Drejtori Menaxhues merr kompensim të, caktuar nga Bordi i Drejtorëve sipas rekomandimit të Kryesuesit, nga FKEE-ja në formë të pagës. Kjo pagë duhet të jetë kompensim i arsyeshëm bazuar në buxhetin e FKEE dhe standardet e tij të qeverisjes korporative.

### **Neni 32**

#### **Shkarkimi i Drejtorit Menaxhues**

1. Bordi i Drejtorëve mund ta shkarkojë Drejtorin Menaxhues në çdo kohë para skadimit të mandatit të tij në bazë të këtij Ligji, nëse ai apo ajo:

1.1. është i papërshtatshëm apo ka humbur pranueshmërinë për të shërbyer si Drejtor Menaxhues sipas kërkesave në nenin 31 të këtij ligji;

1.2. është dënua për vepër penale me vendim të plotfuqishëm të gjykatës me burgim për gjashtë (6) muaj apo më shumë;

1.3. është vetë debitor apo është përfshirë si debitor në procedurë falimentimi apo insolvency.

1.4. për shkak të një sjellje të keqe personale, është diskualifikuar apo suspenduar nga një autoritet kompetent nga ushtrimi i profesionit;

1.5. nuk është në gjendje të ushtrojë funksionet e një mandati të tillë për shkak të ndonjë paafësie mendore apo trupore që ka zgjatur për më shumë se gjashtë (6) muaj;

1.6. sistematikisht mungon nga puna, pa arsye të justifikueshme të paraqitur para Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve;

1.7. FKEE dështon në arritjen e indikatorëve të performancës të përcaktuar në planet vjetore, për arsye që bien nën përgjegjësinë e Drejtorit Menaxhues.

2. Drejtori Menaxhues shkarkohet nga detyra nëse është angazhuar në aktivitete që nuk përputhen me standardet dhe integritetin, në shkelje të Kodit të Etikës së FKEE apo janë të pahijshme për Drejtorin Menaxhues.

3. Procedura dhe procesi i vendimmarrjes për shkarkimin e Drejtorit Menaxhues duhet të zhvillohet siç specifikohet me Rregulloret e brendshme të FKEE.

4. Drejtori Menaxhues ka të drejtë të jep dorëheqje nga pozita e tij me njoftim paraprak prej së paku një (1) muaji.

### **Neni 33**

#### **Parimet funksionale**

1. FKEE do të funksionojë në pajtim me ligjet e Republikës së Kosovës dhe, varësisht nga burimi i fondeve, në pajtim me rregullat dhe kushtet e marrëveshjeve ndërkombëtare të financimit në rast se FKEE shfrytëzon fonde të tilla.

2. Funksionimi i FKEE do të bazohet në parimet themelore në vijim:

2.1. transparenca e plotë gjatë funksionimit, përfshirë transparencën ndaj publikut;

2.2. transparenca në prokurim dhe menaxhim të burimeve financiare;

2.3. respektimi i plotë i parimeve të llogaridhënies dhe raportimit financiar;

2.4. mosdiskriminimi, paanësia dhe mundësitë e barabarta për të gjithë parashtuesit e kërkesave;

2.5. promovimi i partneritetit dhe bashkëpunimit për arritjen e objektivave me sektorin privat, partnerët ndërkombëtarë, institucionet shtetërore të nivelit qendror dhe lokal të Kosovës.

3. Të gjitha investimet e FKEE duhet të bazohen në meritat teknike të projektit dhe aplikuesit të tij.

4. Fondi do të operojë në baza tre (3) vjeçare dhe njëvjeçare programore. Aktivitetet e FKEE do të jenë në përputhje me PKVEE, programet e zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe veprimet e tjera të caktuara në FKEE sipas dispozitave të këtij ligji.

5. FKEE do të veprojë në bazë të qëndrueshme me tarifa apo burime të mjaftueshme për të mbuluar kostot administrative dhe operative të tij.

6. Dokumentet qeverisëse që përbëjnë bazën ligjore për operacionet e Fondit janë ky ligj dhe rregulloret e brendshme që përcaktojnë rregullat dhe procedurat e operimit të FKEE të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve. Rregulloret e brendshme do të përbëhen nga:

6.1. rregulloret që qeverisin parimet dhe modalitetet funksionale të fondit.

6.2 thirrjet e hapura për propozime për përfituesit e përshtatshëm të cilët mund të kërkojnë që të përfitojnë nga instrumentet financiare dhe programet e fondit.

7. Stafi i fondit do të respektojë në plotëni dhe do të veprojë në pajtim me Parimet Funksionale dhe Kodin e Etikës që do të miratohet nga Bordi i Drejtorëve.

### **Neni 34**

#### **Komponentët qarkullues dhe joqarkullues**

1. Për të siguruar qëndrueshmëri, FKEE, në parim, do të funksionojë si mekanizëm qarkullues

i përkufizuar në paragrafin 1.39 të nenit 3 të këtij ligji.

2. FKEE do të mbajë paralelisht një komponent joqarkullues për të ofruar grante, garanci të pjesshme dhe instrumente tjera financiare të parapërtitshme, që mund të shfrytëzohen edhe për kthim të fondeve që FKEE i ofrohen nga institucionet financuese me kushte kthimi. Pavarësisht burimit apo burimeve të financimit, buxheti i përgjithshëm i FKEE për komponentin joqarkullues do të jetë i mjaftueshëm për të mbuluar të gjitha shpenzimet administrative dhe operative në lidhje me këtë komponent.

3. Alokimi i fondeve në komponentin qarkullues apo joqarkullues do të specifikohet në marrëveshjet relevante para transferimit të fondeve në FKEE.

4. Edhe komponenti qarkullues edhe ai joqarkullues i fondit do të monitorohen ndaras, duke përdorur sisteme të ndara monitorimi dhe kontabiliteti.

5. Transferimi i fondeve nga komponenti joqarkullues në komponentin qarkullues ose nga komponenti qarkullues në atë joqarkullues mund të bëhet me vendim të Bordit të Drejtorëve, duke i justifikuar plotësisht arsyet për një vendim të tillë dhe me miratim paraprak të Ministrisë përgjegjëse për sektorin e energjisë dhe Ministrisë së Financave, si dhe miratimin paraprak të donatorit ose të institucionit ndërkombëtar financiar i cili ka ofruar fondet përkatëse, nëse aplikohet.

### **Neni 35**

#### **Tipet e instrumenteve të financimit**

1. FKEE, në bazë të Vendimit të Bordit të Drejtorëve pasi të ketë siguruar pëlqimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrisë së Financave mund të zhvillojë dhe ofrojë Instrumente Financiare të ndryshme nën komponentët qarkullues dhe joqarkullues që promovojnë investime në fushën e eficiencës së energjisë, përfshirë integrimin e burimeve të ripërtitshme të energjisë në mjedise të ndërtuara, siç janë sistemet termike solare, ftohjen dhe ngrohjen gjeotermike, aplikimin e biomasës, dhe të ngjashme.

2. Çdo Instrument Financiar do të dizajnohet dhe implementohet duke respektuar në tërësi legjislacionin lokal të zbatueshëm dhe Marrëveshjet Financiare Ndërkombëtare, në rast se janë të aplikueshme.

3. Në çdo rast, FKEE dhe përfituesit do të nënshkruajnë marrëveshje me të cilat definohen të drejtat dhe obligimet e palëve.

4. Instrumentet financiare dhe marrëveshjet e ndërlidhura mund të përfshijnë, mes tjerash:

4.1. Marrëveshjet për Shërbime Energjetike për projekte që do të implementohen në tërësi përmes fondit, siç definohet në nenin 37 të këtij ligji.

4.2. Llojet e tjera të marrëveshjeve, të kombinuara apo jo me grante për projektet që do të financohen nga FKEE për konsumator të kualifikuar rezidentë dhe mundësisht përfitues të tjerë.

4.3 Instrumentet e tjera të financimit dhe marrëveshjet që synojnë konsumatorët e sektorit publik dhe/apo privat të energjisë për mbështetje dhe/apo zbatim të masave të EE të caktuara për FKEE për të arkivuar caqet e eficiencës së energjisë të përcaktuara me ligjin për eficiencën e energjisë.

5. FKEE do të mbajë llogari të ndara për çdo produkt.

### **Neni 36**

#### **Kushtet e përgjithshme për implementim të Projekteve të përkrahura nga FKEE**

1. FKEE do të monitorojë për së afërmi implementimin e marrëveshjes me përfituesit për të siguruar plotësimin e të gjitha kushteve të përcaktuara në Kontratë në mënyrë transparente dhe profesionale.

2. Procedurat e vlerësimit dhe përbërja e komiteteve të vlerësimit për tenderë të realizuar nga Fondi apo nga përfituesit e Fondit do të përshkruhen në Thirrjen për Propozime. Komitetet e vlerësimit të tenderëve do të përfshijnë detyrimisht një ekspert të specializuar të pavarur që ka ekspertizën e duhur relevante për projektin që po shqyrtohet, i cili do të vërtetojë se tenderi i plotëson kushtet minimale teknike dhe specifikacionet e përcaktuara në Thirrjen për Propozime dhe/ose Dokumentet e Tenderit.

3. Fondi do të kryejë pagesat vetëm pasi të jenë plotësuar kushtet dhe do të aplikojë ndëshkime vetëm në rast të mospajtueshmërisë me marrëveshjet relevante.

### **Neni 37**

#### **Marrëveshjet për Shërbime Energjetike**

1. Marrëveshjet e Shërbimit të Energjisë do të jenë instrumenti kryesor i FKEE për zbatimin e investimeve të efijencës së energjisë në Subjektet Publike në kuadër të komponentit qarkullues.

2. Marrëveshja për Shërbime Energjetike nënshkruhet mes FKEE dhe entitetit publik, me çka FKEE i mundësohet t'i investojë fondet e veta në projekte të efijencës së energjisë dhe ta kthejë investimin nga entiteti publik në bazë të kursimeve të parapara sa i përket kostonë së energjisë.

3. Marrëveshja për Shërbime Energjetike do të implementohet si në vijim:

3.1. FKEE do të lëshojë një Ftesë për Shprehje të Interesit që përcakton të gjitha afatet dhe kushtet e Marrëveshjes së Shërbimit të Energjisë duke përfshirë, mes tjerash, kriteret e pranueshmërisë, kërkesat minimale teknike dhe të tjera, dokumentacionin që duhet të dorëzohet nga aplikuesi, metodologjitë dhe supozimet kyçe për llogaritjen e energjisë bazë dhe kursimet e parashikuara të energjisë, format e aplikimit,

3.2. Në bazë të parimit "shërbehet i pari që pranohet", FKEE do të përcaktojë projektet e pranueshme, të realizueshme dhe me kosto efektive të EE bazuar në kriteret e përcaktuara në Ftesën për Shprehje të Interesit.

3.3 Për çdo projekt të pranueshëm, masat e EE do të përcaktohen në hollësi dhe do të llogaritet energjia bazë dhe kursimet e parashikuara të kostove të energjisë nga investimi.

3.4. Për projektet e përzgjedhura përfundimisht, FKEE do të nënshkruajë Marrëveshje për Shërbime Energjetike me entitetin publik. Kjo kontratë do të përfshijë, mes tjerash:

3.4.1. vlerën e investimit nga FKEE.

3.4.2. kursimet e projektuara të energjisë dhe afatin e kthimit të investimit.

3.4.3. dispozita të qarta të shpagimit kompensimit të investimit tek FKEE.

3.4.4. periudhën e shpagimit kompensimit të investimit tek FKEE, numrin e kësteve dhe shumat e shpagimit, sipas marrëveshjes me pranuesin e investimit.

3.4.5. numrin e kësteve, që bazohet në kursimet e projektuara të energjisë, sipas përcaktimit në kontratën e nënshkruar me FKEE, për një periudhë jo më të gjatë se pesëmbëdhjetë (15) vite, në këste tremujore apo tjera të ngjashme; periudha e shpagimit dhe/ose shumat e kësteve mund të përshtatet ndaj ndryshimeve të mundshme të çmimit të energjisë, me kusht që shumata e gjithmbarshme të shpaguehet përgjatë periudhës jo më të gjatë se pesëmbëdhjetë (15) vite.

4. FKEE do të jetë përgjegjës për organizimin e përgatitjes së specifikacioneve teknike, dizajnimin e projektit dhe dokumentacionit tjetër të ndërlidhur të projektit, prokurimin e punimeve dhe shërbimeve dhe nënshkrimin e të gjitha kontratave me operatorë ekonomikë.

5. Përmbyllja përfundimtare e punimeve dhe shërbimeve do të certifikohet na një komision i pranimit, përbërja e së cilit do të përcaktohet në Thirrjen për Propozime dhe/ose në dokumentacionin e tenderimit.

6. Certifikimi i përmbylljes përfundimtare të projektit konsiderohet vërtetim i kursimeve të projektuara të energjisë dhe institucioni përfitues do ta kthejë investimin e kapitalit tek FKEE, përfshirë të gjitha shërbimet për të cilat është arritur marrëveshja.

7. Marrëveshja e Shërbimit të Energjisë nuk do të konsiderohet si borxh publik sipas ligjit për borxhin publik.

### **Neni 38**

#### **Burimet e financimit të FKEE**

1. Burimet e financimit të FKEE-së përfshijnë:

1.1. kapitali fillestar i Fondit që mundëson themelimin dhe vitet e para të veprimit deri në kohën që Fondi arrin vetë-qëndrueshmëri të plotë. Kapitali fillestar mund të përdoret për të mbuluar shpenzimet e operimit dhe do të ruhet në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për financa. Kapitali fillestar mund të sigurohet ose nga Buxheti i Shtetit ose ndihma e donatorëve ose nga kombinimi i të dy burimeve.

1.2. kontributet e kapitalit nga Qeveria e Kosovës apo donatorët në formë granti apo subvencionit.

1.3. kontributet në natyrë nga Qeveria e Kosovës, siç janë ofrimi i zyrave apo të ngjashme.

1.4. kapitali qarkullues i investuar në formë të Marrëveshjes për Kursim të Energjisë/ MKE apo produkteve tjera.

1.5. të hyrat nga investimet në formë të gjobave, pagesave dhe interesit.

1.6. të hyrat nga interesi i kapitalit dhe aseteve të deponuara.

1.7. kontributet kapitale që dalin nga burime të tjera të përcaktuara me dispozitat e këtij ligji, siç është Skema obligative e Efiçencës së Energjisë.

1.8. huatë.

### **Neni 39**

#### **Tarifat**

1. FKEE do të ngarkojë tarifa për të siguruar qëndrueshmërinë e tij, si në komponentin qarkullues ashtu dhe në atë joqarkullues.

2. Niveli i taksave bazohet në parimin se funksionimi, menaxhimi dhe administrimi i FKEE udhëhiqet nga racionaliteti, efiçienca dhe shfrytëzimi efektiv i burimeve administrative dhe të tjera, dhe në të njëjtën kohë sigurimi i operimit të qëndrueshëm.

### **Neni 40**

#### **Raportimi financiar dhe auditimi**

1. FKEE do të mbajë llogaritë dhe regjistrat në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) për të pasqyruar funksionalitetin e vet dhe gjendjen financiare.

2. Viti financiar i FKEE fillon në ditën e parë të janarit dhe përfundon në ditën e fundit të dhjetorit.

3. FKEE përgatit pasqyrat vjetore financiare në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare të FKEE-së auditohen dhe publikohen jo më vonë se 30 qershor për vitin paraprak.

4. Llogaritë, librat dhe pasqyrat financiare të FKEE-së auditohen nga një auditor i jashtëm i pavarur nga lista e aprovuar e auditorëve ligjor dhe firmave audituese të Këshillit Kosovar për Raportim Financiar dhe i emëruar nga Bordi i Drejtorëve. I njëjti auditor i jashtëm apo firmë auditimi nuk mund të angazhohet për më shumë se tri (3) vjet të njëpasnjëshme.

5. FKEE duhet t'ja dorëzoj pasqyrat e audituara financiare Bordit të Drejtorëve për aprovim.

6. Drejtori Menaxhues është përgjegjës që Bordit të Drejtorëve t'i dorëzohen pasqyrat e audituara financiare të FKEE së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para finalizimit dhe aprovimit të tyre.

7. FKEE duhet të publikojë raportin vjetor dhe pasqyrat e audituara financiare në faqen e vet në internet.

8. Raporti vjetor do të përfshijë, mes tjerash, të gjitha informatat relevante mbi aktivitetet dhe objektivat e arritura gjatë vitit të raportimit, listën e projekteve, burimet financiare të investuara, të kthyerat dhe në dispozicion.

9. FKEE raportet vjetore ia dërgon Qeverisë së Republikës së Kosovës, jo më vonë se deri më 31 mars të vitit vijues për vitin paraprak fiskal.



10. Si entitet publik, FKEE gjithashtu i nënshtrohet auditimeve nga Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës.

## **KREU VIII DISPOZITAT NDËSHKUESE**

### **Neni 41**

#### **Sanksioni kundërvajtës me gjobë**

1. Inspektori për energji për shkeljet e konstatuara me këtë ligj shqipton gjobë për kundërvajtje.

2. Për shkeljen e nenit 11 dhe 12 të këtij ligji ndëshkohet me gjobë për kundërvajtje, si në vijim:

2.1. personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik prej tridhjetë (30) euro deri dymijë (2000) euro;

2.2. personi fizik që ushtron biznes individual prej dyqind (200) euro deri në pesëmijë (5000) euro;

2.3. personin juridik prej pesëqind (500) euro deri në njëzetmijë (20.000) euro.

3. Në vendimin për kundërvajtje përcaktohet afati i pagesës së gjobës prej pesëmbëdhjetë (15) deri në nëntëdhjetë (90) ditë.

4. Në rastin e pagimit të gjobës në afatin e përcaktuar më urdhrin kundërvajtës, i dënuari lirohet nga pagimi pesëdhjetë përqind (50%) nga shuma e gjobës së shqyrtuar.

5. Nëse kryesi pjesërisht ose në tërësi nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar, Inspektorati duhet të fillojë procedurën gjyqësore në gjykatën kompetente.

6. Pas pagesës së gjobës, duhet që një kopje e pagesës t'i dorëzohet inspektorit për energji.

7. Operatorët e sistemit të transmetimit, shpërndarësit e energjisë, si dhe furnizuesit e energjisë me pakicë që pengojnë zhvillimin e tregut të shërbimeve të energjisë, duke përfshirë bllokimin e qasjes në tregun e shërbimeve të energjisë për Konkurrentët dhe duke ushtruar abuzimin e pozitës dominuese, sanksionohen në përputhje me Ligji i Konkurrencës nga Komisioni i Konkurrencës.

8. Kundër vendimit të inspektorit për energji, pala e pakënaqur në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, mund ti parashtrorë ankesë Inspektoratit për Energji, i cili në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të ankesës vendos sipas ankesës. Ankesa e parashtruar kundër vendimit të inspektorit për energji nuk e shtynë ekzekutimin e këtij vendimi.

9. Kundër vendimit të Inspektoratit për Energji sipas ankesës pala e pakënaqur ka të drejtë që të ngritë kontest administrativ në pajtim me ligjin në fuqi mbi procedurën e përgjithshme administrative.

10. Për sa i përket zbatimit të Skemës obligative të efiçencës së energjisë, dispozitat e veçanta

të nenit 10 të këtij ligji do të jenë të aplikueshme, në vend të dispozitave të këtij neni

## **KREU IX DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 42 Aktet nënligjore**

1. Ministria nxjerr aktet nënligjore me qëllim të zbatimit të këtij ligji, si në vijim:

- 1.1. Udhëzim Administrativ për llogaritjen e energjisë elektrike nga bashkëprodhimi .
- 1.2. Udhëzim Administrativ për Metodologjinë për përcaktimin e efiçencës nga procesi i bashkëprodhimit.
- 1.3. Udhëzim Administrativ lidhur me kërkesat për efiçencën e energjisë për blerjen e produkteve, shërbimeve dhe ndërtesave nga institucionet e nivelit qendror.
- 1.4. Udhëzim Administrativ për Përmbajtjen e energjisë së lëndëve djegëse të përcaktuara për përdorim fundor.
- 1.5. Udhëzim Administrativ për metodat dhe parimet e përbashkëta për llogaritjen e ndikimit të efiçencës së energjisë.
- 1.6. Rregullore për kriteret minimale për auditimet e energjisë përfshirë ato të kryera si pjesë e sistemeve të menaxhimit të energjisë.
- 1.7. Rregullore për kërkesat minimale për faturimin dhe informacionin e faturimit bazuar në konsumin aktual .
- 1.8. Udhëzim Administrativ për potencialin e efiçencës në ngrohje dhe ftohje.
- 1.9. Udhëzim Administrativ për kushtet e përgjithshme për analizën e kosto-përfitimit.
- 1.10. Udhëzim Administrativ për Certifikatë/Garancinë e origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga bashkëprodhimi me efiçencë të lartë
- 1.11. Udhëzim Administrativ për kriteret e efiçencës së energjisë për rregullimin e rrjetit të energjisë dhe për tarifat e rrjetit të energjisë elektrike.
- 1.12. Udhëzim Administrativ për kërkesat e efiçencës së energjisë për operatorët e sistemit të bartjes dhe operatorët e sistemit të shpërndarjes.
- 1.13. Udhëzues për mënyrën e raportimit për raportet vjetore dhe për progresin e Planit Kombëtar të Veprimit për Efiçencë të Energjisë.

2. Përveç paragrafit 1 të këtij neni, Qeveria, Ministria, Zyra e Rregullatorit për Energji ose

institucione të tjera relevante mund të nxjerrin akte të tjera nënligjore, sipas nevojës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

3. Qeveria e Kosovës, me propozim të Ministrisë, brenda tre (3) muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të ndërmarrë të gjitha procedurat e domosdoshme për të themeluar Bordin e Drejtorëve të FKEE, në pajtim me nenin 25 dhe 27 të këtij ligji.

4. Me qëllim të zbatimit të dispozitave të këtij ligji në lidhje me Fondin e Kosovës për Efiçencën e Energjisë, Bordi i Drejtorëve të FKEE-it harton rregulloret e brendshme të parapara me këtë ligj, brenda gjashtë (6) muajve, nga data e funksionimit të Bordit të Drejtorëve. Bordi i Drejtorëve lëshon së paku Rregulloret e Brendshme në vijim:

- 4.1. Parimet e Përgjithshme dhe Kodi i Etikës i FKEE.
- 4.2. Rregullorja për organizimin e brendshëm të FKEE.
- 4.3. Rregullorja për rregullat e brendshme të punës së FKEE.
- 4.4. Plani i zhvillimit të biznesit të FKEE që mbulon periudhën tre (3) vjeçare.
- 4.5. Rregullorja për përgatitjen e buxhetit vjetor.
- 4.6. Standardet dhe procedurat e brendshme të kontabilitetit.
- 4.7. Rregullorja për pagesën e stafit të FKEE.
- 4.8. Rregullorja për procedurën dhe kriteret e punësimit të stafit FKEE.
- 4.9. Rregullorja për përgatitjen dhe shpalljen e thirrjeve për propozime.
- 4.10. Rregulloret e tjera sipas nevojës në përputhje me këtë ligj.

5. Përveç rregulloreve të brendshme të parashikuara në paragrafin 4 të këtij neni, Bordi i Drejtorëve shpall thirrje për propozime për produkte specifike të fondit.

### **Neni 43** **Dispozitat përfundimtare**

1. Qeveria e Kosovës, përmes Ministrisë, brenda gjashtë (6) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr të gjithë aktet nënligjore të parashikuara nga ky ligj, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në këtë ligj.

2. Qeveria e Kosovës, përmes Ministrisë, brenda tre (3) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të ndërmarrë të gjitha procedurat e nevojshme për të themeluar Bordin e Drejtorëve të FKEE në përputhje me nenin 27 të këtij ligji.

3. Ky ligj shfuqizon Ligjin Nr. 04/L-016 për Efiçencën e Energjisë .

4. Me kusht që mos të jenë në kundërshtim me këtë ligj dhe deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore për zbatimin e duhur të këtij ligji, aktet nënligjore të zbatueshme do të vazhdojnë të mbesin në fuqi.

**Neni 44**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 06/L -079**  
**07 nëntor 2018**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-056-2018, datë 23.11.2018 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi**